



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.161

10 dhjetor

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.752, datë 2.11.2011

Për miratimin e projektdokumentit të programit buxhetor
afatmesëm, 2012-2014.....

7683

VENDIM
Nr.752, datë 2.11.2011

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM,
2012-2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e projektdokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm, për periudhën 2012-2014, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PËRMBLEDHJE

Dokumenti i planit të shpenzimeve dhe investimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2012-2014, përbën finalizimin e fazës së dytë, të procesit të përgatitjes së Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, proces ky i iniciuar përmes vendimeve të Komitetit të Planifikimit Strategjik (KPS) për përcaktimin e kuadrit makro-fiskal 2012-2014 dhe tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014.

Këtë vit kërkesat buxhetore janë paraqitur në mënyrë më të plotë në krahasim me vitin e kaluar, pasi në këtë proces për herë të tretë janë përfshirë të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre. Për herë të tretë nga institucionet buxhetore është konceptuar paraqitja e kërkesave për buxhet mbi bazë programi dhe produktesh, duke realizuar deri diku, lidhjen e politikave me shpenzimet. Megjithatë, në këtë fazë të përgatitjes së këtyre kërkesave, cilësia e tyre ende nuk paraqitet në nivelin e kërkuar dhe kjo do të jetë një sfidë për vitet e tjera të përgatitjes së kërkesave buxhetore, si dhe në vitet në vazhdim. Një vit më parë i gjithë procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Strategji, Buxhet dhe Integrim (GSBI), i cili është ngritur në çdo ministri linje në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr.78, datë 8.5.2006 “Për krijimin e grupeve ministrore të punës për strategji, buxhet dhe integrim “GSBI” nga ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GSBI-së (Sekretari i Përgjithshëm) në çdo ministri. Në mënyrë të ngjashme, në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8/2, datë 6.7.2011 “Për përgatitjen e buxhetit dhe fondet speciale të tyre”, është drejtuar dhe organizuar ky proces edhe në institucionet e tjera buxhetore.

Dokumenti i PBA-së 2012-2014 paraqet në detaje qëllimet, objektivat dhe produktet e programeve të secilës prej ministrive të linjës, në nivel programi për vitet 2012, 2013 dhe 2014, si dhe një përmbledhje të kërkesave buxhetore të institucioneve të tjera buxhetore të përfshira për herë të tretë në këtë proces. Kështu, ky dokument ka mundur të realizojë për një kuadër afatmesëm lidhjet mes qëllimeve dhe objektivave të politikave, me alokimin e burimeve buxhetore, përkatësisht në nivel programi.

Është e rëndësishme për t’u theksuar fakti se, me rritjen progresive të vëmendjes kushtuar procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, kapaciteti i menaxhimit po përmirësohet vazhdimisht me kalimin e kohës. Gjithashtu, sistemi i planifikimit të integruar dhe veçanërisht, miratimi i strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim, janë bazat e forcimit të vazhdueshëm të procesit të PBA-së, nëpërmjet sigurimit të informacionit të nevojshëm në nivel strategjik të politikave.

Në vijim, dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014 është i strukturuar në katër kapituj:



- Kapitulli i parë përshkruan rolin e PBA-së si një instrument i menaxhimit të shpenzimeve publike, pjesë përbërëse e sistemit të planifikimit të integruar, si edhe termat kohorë që procesi i PBA-së ka ndjekur gjatë vitit buxhetor.
- Kapitulli i dytë përshkruan kuadrin makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2012-2014.
- Kapitulli i tretë paraqet në mënyrë të përmbledhur informacionin e siguruar nga ministritë e linjës lidhur me Programin Buxhetor Afatmesëm 2012-2014 dhe konkretisht qëllimet, objektivat dhe produktet e politikës për secilin prej programeve të tyre për vitet 2012, 2013 dhe 2014.
- Kapitulli i katërt paraqet tavanet përgatitore të shpenzimeve për periudhën 2012-2014, për çdo njësi të qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre.

Hyrje

A.1 Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA)

1. Programi Buxhetor Afatmesëm është një instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent kyç i sistemit të planifikimit të integruar. Ai është rezultat i të dyja proceseve: rishikimit të politikave dhe planifikimit të shpenzimeve. Planet e shpenzimeve hartohen nga ministritë e linjës brenda burimeve që qeveria ka në dispozicion. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Qeverisë për tri vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor.

2. Qëllimet kryesore të PBA-së janë:

- Inkurajimi i efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike;
- Lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve strategjiko-politike të Qeverisë me shpërndarjen e burimeve publike dhe kryerjen e shpenzimeve publike;
- Promovimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal;
- Zgjerimi i vizionit të procesit buxhetor duke siguruar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare).

Dokumenti i PBA-së hartohet nga Ministria e Financave dhe i jep mundësinë Këshillit të Ministrave për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh brenda periudhës afatmesme që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korente dhe kapitale publike.

Gjithashtu, ai u shërben njësive të qeverisjes qendrore dhe fondeve speciale të tyre, pasi mundëson përcaktimin prej tyre të politikave dhe programeve në një strukturë koherente, si dhe mundësinë për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen te programet prioritare në periudhën afatmesme.

Duhet theksuar, gjithashtu, që procesi i hartimit të PBA është i orientuar mbi bazën e performancës. Përparësitë e kësaj mënyre të re të konceptimit të planifikimit të shpenzimeve konsistojnë në përfundimin e:

- Kontributit të qartë të produkteve në përmbushjen e objektivave të politikës;
- Produkteve të matshme;
- Aktiviteteve të kostueshme.

A.2 Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim, me një horizont planifikimi prej 7 vitesh, përcakton strategjitë dhe synimet afatshkurtra dhe afatgjata për të gjithë sektorët, bazuar në një vizion kombëtar. Për arritjen e një prej synimeve kryesore të SKZHI-së, anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, një rol të rëndësishëm luajti edhe Programi Buxhetor Afatmesëm. Ky program do t'i shërbejë edhe arritjes së aspiratave të SKZHI-së për integrimin europian.

Për procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, elementi strategjik i PBA-së u siguroi nëpërmjet konsultimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale përgjatë procesit të Rishikimit të Politikës së Programit - përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave për çdo program shpenzimesh të çdo ministrie. Ky proces u ndërmor nga një bashkëpunim i ngushtë ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Integritetit dhe Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, në Kryeministri.

A.3 Procesi i përgatitjes së PBA-së 2012-2014

Tabela 1, paraqet në mënyrë të përmblëdhur hapat kryesorë në procesin e përgatitjes së PBA-së 2012-2014, të ndërmarrë në përputhje me kalendarin e sistemit të planifikimit të Integruar të miratuar nga komiteti i planifikimit strategjik.

Tabela 1 Fazat e përgatitjes së PBA-së

Fazat	Koha	Përshkrimi
1. Kuadri makroekonomik, vendosja e prioritetëve dhe përgatitja e tavanëve të PBA-së për secilin ministri	Tremujori I	Përgatitja e tavanëve të përgjithshme dhe vendosja e treguesve makroekonomikë përmes parashikimit makroekonomik. Identifikimi i prioritetëve të politikave dhe zërave me ndikim të rëndësishëm në shpenzime e të ardhura (pagat, transfertat vendore, programet e reja, projektet kryesore të investimeve publike). Vendosja e tavanëve përgatitore të PBA-së. Përgatitja e udhëzimit për përgatitjen e buxhetit.
Qeveria miraton parashikimin makro, tavanet e përgjithshme dhe tavanet përgatitore të PBA-së 3-vjeçare për çdo ministri		
2. Rishikimi i Politikës së Programit (RPP).	Tremujori II	Ministritë vendosin politikat për çdo program dhe identifikojnë qëllimet dhe objektivat e programit.
3. Plani i shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP).	Tremujori II	Brenda tavanëve të përcaktuara, ministritë zhvillojnë PSHIP, duke identifikuar produktet dhe duke i kostuar aktivitetet në bazë të fondeve në dispozicion për çdo program. Dorëzimet e PBA-së janë plotësisht të reflektuara në planin e integruar të ministrisë.
Qeveria miraton projekt-dokumentin e PBA-së		
4. Përgatitja e buxhetit	Tremujori III	Përgatitja e udhëzimit plotësues për përgatitjen e buxhetit. Ministritë paraqesin buxhetet e detajuara.
Qeveria miraton projektin e PBA-së të rishikuar dhe projektligjin e buxhetit dhe i dërgon në Kuvend përkatësisht për informim dhe miratim		
5. Shqyrtimi në Kuvend	Tremujori IV	Shqyrtimi dhe miratimi i ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi.
Shënim. Dokumenti përfundimtar i PBA-së publikohet në fillim të vitit pasardhës pas miratimit të ligjit vjetor të buxhetit nga Kuvendi.		

A.3.1 Rishikimi i Politikës së Programit (RPP)

Nevoja kryesore për një menaxhim efektiv të financave publike është përcaktimi i qartë i politikave. Për politikat e reja kjo mund të arrihet nëpërmjet zbatimit të një procesi të mirë të përcaktimit të politikave, domethënë nëpërmjet përmirësimit të hartimit të politikave.

Në praktikë, procesi i hartimit të politikave nuk ka qenë gjithmonë i frytshëm për sa i përket qartësisë së politikave. Procesi i PBA-së merr një rendësi parësore në përpjekjet e qeverisë për të lidhur buxhetin vjetor me politikat e tij. Për të arritur këtë, politikat duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të rishikohen rregullisht nëpërmjet një procesi të rishikimit të politikës së programit, i cili është i integruar me procesin e planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve, përcaktimit të kostove dhe përgatitjes së buxhetit.

A.3.2 Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit (PSHIP)

Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve të Programit është pjesë e planifikimit strategjik dhe pason rishikimin e politikës së programit. Ai përfaqëson pjesën kryesore të procesit të përgatitjes së PBA-së. PSHIP ndërmerret në kontekstin e politikës makroekonomike dhe veçanërisht të nevojës për stabilitet fiskal.

Ai realizohet, gjithashtu, në kontekstin e prioritetëve strategjike të Qeverisë dhe të qëllimeve dhe objektivave të politikës së përcaktuar për çdo sektor, domethënë, nëpërmjet rishikimit të politikës së programit. PSHIP reflekton mënyrën se si Qeveria dëshiron t'i alokojë burimet e saj për secilin sektor.

Një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i PSHIP-së të jetë në përputhje me kuadrin makroekonomik e fiskal dhe prioritetet strategjike të Qeverisë, është vendosja e tavanëve të shpenzimeve, që përbën kufirin maksimal që mund të shpenzohet ose të planifikohet për t'u shpenzuar, për një qellim të caktuar. PSHIP-ja ndërmerret nga ministritë e linjës duke përdorur sistemin e informatizuar të Ministrisë së Financës për Planifikimin e Shpenzimeve dhe Investimeve të Programeve. Për njësitë e qeverisjes qendrore që u përfshinë për herë të tretë në këtë proces dhe që nuk kanë akses në sistemin e



informatizuar, planifikimi i shpenzimeve u mundësua nëpërmjet formateve përkatëse të përcaktuara në udhëzimin e përgatitjes së buxhetit.

A.3.3 Kërkesat për shpenzime të PBA

Pas përfundimit të fazës së PSHIP, njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre paraqesin kërkesat përkatëse për shpenzime të PBA. Këto kërkesa duhet të jenë rigorozisht brenda tavanëve të përcaktuara nga Komiteti i Planifikimit Strategjik pranë Këshillit të Ministrave, si dhe të jenë të miratuara nga titullarët respektivë.

A.3.4 Kërkesat shitesë për shpenzime të PBA-së

Kërkesat shitesë për shpenzime të PBA-së paraqesin nevojat për financim të programeve përkatëse të njërive të qeverisjes qendrore dhe fondeve speciale të tyre, të cilat nuk mund të mbulohen brenda tavanëve të përcaktuara nga Ministria e Financave. Këto kërkesa përfshijnë, gjithashtu, një shpjegim se pse njësi e qeverisjes qendrore përkatëse nuk mund të sigurojë një kursim eficient nga programet e tjera.

Miratimi i kërkesave shitesë të PBA-së, për një ose më shumë njësi të qeverisjes qendrore, kërkon rialokimin e burimeve nga programet më pak prioritare të njërive të tjera të qeverisjes qendrore, e cila vendoset nga Këshilli i Ministrave.

A.3.5 Miratimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014

Pas analizës dhe shqyrtimit të kërkesave për shpenzime të PBA-së dhe kërkesave shitesë të PBA-së, Ministria e Financave përgatit materialin e përmbledhur në projektdokumentin e PBA-së, i cili paraqitet për shqyrtim pranë Komitetit të Planifikimit Strategjik dhe më pas për miratim përfundimtar pranë Këshillit të Ministrave.

A.3.6 Roli i Ministrisë së Financave

Roli i Ministrisë së Financave është kryesor dhe shumë i rëndësishëm. Nuk është roli i saj primar për të analizuar objektivat dhe qëllimet e politikave të sektorit, kjo është përgjegjësi e Këshillit të Ministrave. Roli i saj kryesor është që, gjatë fazës së rishikimit të politikës së programit, të sigurojë që politika, objektivat dhe qëllimet janë të përcaktuara qartë dhe se programet mbështetëse dhe rezultatet e synuara do të plotësojnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon vlerë për para që do të thotë në mënyrë ekonomike, eficiente dhe efektive.

Ndërsa, roli i Ministrisë së Financave në fazën e planifikimit të shpenzimeve dhe investimeve të programit është i dyfishtë.

i) Detyra e saj e parë është t'i bëjë propozime Këshillit të Ministrave për tavanet e përgjithshme të shpenzimeve dhe tavanet përgatitore të PBA-së.

ii) Ndërsa detyra e saj e dytë, ka të bëjë me vlerësimin e faktit nëse ministritë po arrijnë eficientë, efektivitetin dhe ekonomi në zbatimin e programeve, gjë të cilën ajo e mban parasysh kur bën propozim e tavanëve përgatitore të PBA-së.

A.3.7 Roli i Komitetit të Planifikimit Strategjik

Komiteti i Planifikimit Strategjik është një strukturë e krijuar pranë Këshillit të Ministrave, e cila kryesohet nga Kryeministri. Roli i këtij Komiteti është thellësisht koordinues dhe vendimmarrës, pasi të gjitha propozimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me sistemin e planifikimit të integruar në përgjithësi, dhe Programit Buxhetor Afatmesëm në veçanti, kalojnë detyrimisht për shqyrtim pranë këtij Komiteti përpara se të marrin miratimin përfundimtar pranë Këshillit të Ministrave.

Në procesin e përgatitjes së PBA, Komiteti i Planifikimit Strategjik dhe Këshilli i Ministrave luajnë një rol parësor në drejtim të miratimit të një sërë etapash të rëndësishme të tilla si:

- Kuadri makroekonomik dhe fiskal për periudhën e PBA-së;
- Tavanet përgatitore dhe përfundimtare të PBA-së;
- Kalendari i SPI-së;
- Projektdokumentin e PBA-së;
- Dokumentin e PBA-së të rishikuar.

B. Kuadri makroekonomik dhe fiskal për periudhën 2012-2014

Kuadri fillestar makroekonomik e fiskal për periudhën 2012-2014 është pjesë e sistemit të planifikimit të integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave. Kuadri makroekonomik e fiskal


përgatitet me qëllim që të ofrohet informacion për përcaktimin e përparësive strategjike, shpenzimeve agregate, synimeve në lidhje me të ardhurat dhe deficitin, si edhe për përcaktimin e tavanëve për të filluar procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) në nivel ministrie. Kuadri fillestar makroekonomik e fiskal miratohet nga Komiteti i Planifikimit Strategjik në muajin e parë të çdo viti, dhe është subjekt rishikimi dhe përditësimi në dy momente kyçe gjatë vitit; në muajin maj, përpara finalizimit të PBA-së dhe të tavanëve të PBA-së për shpenzimet, dhe në muajin shtator, përpara dërgimit në parlament të projektbuxhetit të shtetit.

Kuadri makroekonomik e fiskal për periudhën 2012-2014 përbëhet nga dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë paraqiten vlerësimet mbi zhvillimet ekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2010 dhe tremujorit të parë të vitit 2011, dhe pjesa e dytë trajton parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomikë, parashikimin e burimeve në dispozicion të qeverisë dhe shpërndarjen e tyre për periudhën 2012-2014.

B.1 Zhvillimet makroekonomike

Gjatë dekadës së fundit ekonomia shqiptare ka njohur një progres të qëndrueshëm. Proceset e transformimit ekonomik dhe ristrukturimit dhe politikat makroekonomike të ndjekura në 10 vitet e fundit kanë rezultuar në një nga ritmet e rritjes më të lartë në rajon. Me një rritje mesatare vjetore prej rreth 6 për qindësh, PBB-ja për frymë është më shumë se trefishuar në këtë periudhë. Ulja e barrës tatimore dhe lehtësirat administrative, kanë ndihmuar biznesin për t'u bërë më produktiv. Zhvillimet pozitive në sektorin e biznesit, veçanërisht në atë industriale dhe në atë të orientuar drejt shërbimeve, çoi në një rritje të punësimit dhe të të ardhurave familjare. Të ardhurat, në një pjesë të tyre të financuara nga remitancat dhe nga zgjerimi i kredisë tregtare, kanë kontribuar për një kërkesë të fortë të brendshme, e cila ka sjellë nxitjen e investimeve kapitale gjithnjë dhe më të larta, si dhe të zgjerimit të prodhimit.

Gjatë viteve të fundit, stabiliteti makroekonomik në vend ka ndjerë presionet e krizës ndërkombëtare financiare, megjithatë është arritur të ruhet në parametra relativisht të kënaqshëm. Norma e rritjes për vitin 2009 ishte 3.3 %, një nga normat e pakta pozitive të regjistruara në Europë. Kjo u ndihmua nga ndjekja e një politike ekspansioniste fiskale, e cila është reflektuar kryesisht në përshejtimin e investimeve publike që arriti në nivelin 9,9 % të PBB-së, duke kompensuar kështu rënien në kërkesën e jashtme dhe ngadalësimin e kërkesës së brendshme. Në vitin 2010, politika fiskale u rivendos përsëri në një rrugë të qëndrueshme drejt konsolidimit të financave publike dhe të deficitit fiskal, u reduktua në 3 % të PBB-së nga 7.1 %, që ishte në vitin 2009. Forcimi i shpejtë i eksporteve ishte kontribuesi kryesor në ruajtjen e ritmeve të rritjes, vlerësuar në rreth 3,8 %, ndërkohë që investimet dhe sidomos konsumi kanë pasur një rritje të ngadaltë. Gjatë kësaj periudhe papunësia pa vetëm një rënie të moderuar dhe është aktualisht e qëndrueshme në 13,5 %. Inflacioni është nën kontroll brenda intervalit objektiv të bankës qendrore prej 2-4 %. Në tetor 2010, Shqipëria arriti të bëjë shfaqjen e parë të saj të eurobondit 5-vjeçar prej 300 milionë në tregun ndërkombëtar në terma relativisht mjaft të kënaqshëm, respektivisht me një afat maturimi prej pesë vjetësh, me një normë interesi maksimal 7,5 %.



Sektori real

Brenda një konteksti me pasiguri të larta ekonomike botërore në 2010, Shqipëria ka vazhduar të përjetojë ecuri të kënaqshme ekonomike. Sipas të dhënave paraprake nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT),

PBB-ja reale u rrit me 5.4 % në tremujorin IV-të 2010, duke përshejtuar ritmin e saj nga 5.0 % në T-3, 3.0 % në T-2, dhe 2.2 % në T-1 të vitit 2010 dhe nga një performancë negative prej -0,6 % në T-4 të vitit 2009. Përshejtimi në rritjen vjetore të PBB-së reale është mbështetur nga reagimi i industrisë, ku vlera e shtuar bruto u rrit me 18.7 % në T-1 të 2010, 21.1 % në T-2, 17.1 % në T-3 dhe 22.2 % në T-4 të po këtij viti (nga 2.1 % që ishte në vitin 2009) Rritja ekonomike ka vazhduar të jetë pozitive edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2011, edhe pse kjo rritje rezultoi më e ulët nga parashikimet



fillestare dhe kjo si rezultat i disa faktorëve, dhe veçanërisht si rezultat i faktorëve të brendshëm joekonomikë. Rritja ekonomike e vlerësuar për tremujorin e parë ishte 3.4%, ndërkohë që treguesit indirektë të disponueshëm tregojnë se edhe gjatë tremujorit të dytë rezulton një rritje pozitive në të njëjtat nivele.

Analiza strukturore e aktivitetit industrial tregon kërkesë më të fortë për industrinë nxjerrëse (me rreth 65 %), po ashtu edhe për energjinë elektrike, gazin dhe aktivitet e ujit (me rreth 34 %). Edhe pse dinamika e rritjes së ritmit vjetor të parë në këtë sektor përfshin një efekt strukturor, si ndikues bazë do të merren parasysh kontributet pozitive të rimëkëmbjes së partnerëve kryesorë tregtarë të ekonomisë shqiptare, si: çmimet më të larta të mallrave industriale në tregun ndërkombëtar dhe zhvlerësi relativ i monedhës vendase siç është ilustruar nga eksportet e larta të produkteve industriale. Zhvillimet e ekonomisë reale gjatë vitit 2010 mbështeten edhe nga indekse të tjera afatshkurtra (3-mujore), të tilla si indeksi i afarizmit, numri i punonjësve dhe nga indeksi fondit total te pagave.

Ndonëse nuk janë ende të disponueshme të dhënat statistikore të llogarisë kombëtare sipas metodës së shpenzimeve, në bazë të treguesve të tjerë indirekt të disponueshëm, duket se kërkesa e brendshme, si për konsumin ashtu dhe për investimet, ka pësuar një rritje të ngadaltë gjatë gjithë 2010-s. Vihet re se, që nga tremujori i katërt i vitit 2010 dhe më qartë gjatë katër muajve të parë të 2011, importet e të mirave kapitale (makinerive) janë rritur në mënyrë të qëndrueshme. Rritja në importet e makinerive, rritja e dukshme e kredisë për sektorin privat për qëllime investimi, si dhe rritja e investimeve publike në krahasim me 2010, në mënyrë të qartë tregojnë për një rigjenerim të investimeve në 2011-n krahasuar me vitin 2010.

Kërkesa e jashtme ka vazhduar të gjenerojë rritje pozitive edhe gjatë 2011-s, ndonëse në një masë konsiderueshëm më të ulët se në 2010. Ndërsa rritja e konsumit dhe investimeve, edhe pse vlerësohet të jetë pozitive krahasuar me vitin 2010, mbetet e ngadaltë duke reflektuar kryesisht zbehjen e besimit të konsumatorëve dhe bizneseve gjatë gjysmës së parë të vitit. Aktivitete ekonomike me performancën më të mirë gjatë gjysmës së parë të vitit ishin industria, transporti dhe tregtia, ndërsa sektori i ndërtimit duket se po rikthehet në terren pozitiv, pasi shënoi një rritje pozitive prej 4.4% gjatë tremujorit të parë të 2011-s, pas pesë tremujorësh rresht me rritje të thellë negative.

Pozicioni i jashtëm i vendit u përkeqësua disi gjatë gjysmës së parë të 2011-s. Bilanci i pagesave regjistroi një deficit prej 79 milionë eurosh gjatë gjysmës së parë të vitit nga një deficit prej 7 milionë eurosh i regjistruar një vit më parë. Deficit i llogarisë korente u rrit me 34% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke reflektuar ngadalësimin e rritjes së eksportit të mallrave në nivelin 18% gjatë gjysmës së parë të 2011-s nga një rritje prej 66% që shënonte në 2010-n. Ndërsa rritja e importeve u përshpejtua në 13% nga 3% regjistruar gjatë vitit 2010. Përveç përkeqësimit të bilancit tregtar, rënia e remitançave me 12% dhe rritja e flukseve dalëse për turizëm dhe udhëtime ishin kontribuuesit kryesorë në përkeqësimin e llogarisë korente dhe bilancit të pagesave gjatë gjysmës së parë të 2011-s. Megjithatë, kursi i monedhës vendase kundrejt valutave mbeti përgjithësisht i stabilizuar, borxhi i jashtëm bruto i Shqipërisë (publik dhe privat) është rritur me vetëm 2% që nga fundi i 2010-s dhe rezervat ndërkombëtare janë të mjaftueshme për të financuar rreth 4.3 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Besimi mbi sektorin financiar dhe bankar është rikthyer plotësisht pas goditjeve negative të shkaktuara prej krizës globale. Depozitat bankare u rritën me 18.5% në 2010 krahasuar me vitin 2009 dhe është vënë re një përshpejtim i rritjes së tyre përgjatë gjithë vitit. Kredia mbi ekonominë është rritur, gjithashtu, edhe pse me ritme më të moderuara se depozitat. Normat e interesit janë ulur gradualisht gjatë gjysmës së parë të 2010-s dhe janë stabilizuar në fund të vitit. Gjithashtu, treguesit e rentabilitetit janë përmirësuar gjatë 2010-s krahasuar me 2009-n. Dinamika pozitive e sektorit financiar ka vijuar edhe përgjatë vitit 2011. Depozitat u rritën me 15.2% deri në korrik 2011 (në terma vjetorë), ndërsa kredia mbi ekonominë është rritur me 12.5% dhe ritmi i rritjes së saj është përshpejtuar gjatë vitit. Kredia ndaj sektorit privat udhëheq rritjen në kredinë totale, duke u rritur me 16% në terma vjetorë dhe kryesisht për qëllime investimi, por edhe kredia ndaj konsumatorëve familjarë është përshpejtuar në muajt e fundit duke arritur një rritje prej 5.4% në korrik 2011 (në terma vjetorë). Sektori bankar është likuid, gjë kjo e reflektuar edhe në ankandet e fundit të bonove të thesarit (yield-et më të ulëta dhe ofertë më e lartë nga

bankat). Megjithatë, niveli e kredive me probleme ende mbetet një problem në sektorin financiar. Niveli i tyre arriti në 16.6% në tremujorin e dytë të 2011-s nga niveli prej 13.6% në fundin e 2010-s. Në të njëjtën kohë, kjo është shoqëruar me rritje të nivelit të provigjioneve të mbajtura nga bankat në nivelin e 9.7% të totalit të kredive nga 8.2% që ishte në fundin e vitit 2010. Ndërkohë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit mbetet në nivel mjaftueshmërisht të sigurt prej 14.6%, mbi minimumin e kërkuar nga Banka e Shqipërisë prej 12%.


Kushtet e tregut të punës janë përmirësuar disi në tremujoret e fundit të 2011-s, pas stagnacionit në vitin 2010, duke pasqyruar rimëkëmbjen në aktivitetin ekonomik. Punësimi në sektorin privat jobujqësor u rrit me 4.3 % në terma vjetorë në T-1 të 2011 dhe vazhdoi të rritet me 6.5 % ose 15,689 persona më shumë në T2 të po këtij viti, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Përmirësimi i punësimit në sektorin privat jobujqësor ka reflektuar kryesisht rritje të numrit të të punësuarve në Industri dhe në sektorët e shërbimeve. Këta janë sektorët me performancën më të mirë në aspektin e vlerës së shtuar në rritje. Në të kundërt, të punësuarit në sektorin e ndërtimit pësoi një rënie.

Totali i punësimit në sektorin privat (me përjashtim të sektorit bujqësor) është rritur me rreth 10,474 person krahasuar me T-2 të 2010. Në sektorin publik, punësimi ka mbetur pothuajse i pandryshuar nga 3-mujori në 3-mujor, ndërsa gjatë T -2 2011 numri i të punësuarve në këtë sektor është ulur me rreth 1,500 persona krahasuar me T-2 2010. Numri i personave të papunë gjatë T-2 të vitit 2011, në krahasim me të njëjtin 3-mujor të një viti më parë është ulur me rreth 2,573 persona. Shkalla e papunësisë për T-2 të vitit 2011 ishte 13.26% duke shënuar një rënie prej 0.17% krahasuar me T-1 të vitit 2011 dhe rreth 0.52% krahasuar me T-2 të vitit 2010.

Sektori monetar

Norma mesatare e inflacionit në gjysmën e parë të 2011-s, ishte pak mbi limitin e sipërm të objektivit të Bankës së Shqipërisë, kjo kryesisht si rezultat i çmimeve më të larta të ushqimeve dhe naftës, reflektim ky i zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare. Që nga qershori i 2011-s, presionet inflacioniste janë zbehur dhe norma mesatare e inflacionit ra në nivelin 2.8% në muajin shtator 2011.

Dinamika pozitive e sektorit financiar ka vijuar edhe përgjatë vitit 2011. Depozitat u rritën me 15.2% deri në korrik 2011 (në terma vjetorë) ndërsa kredia mbi ekonominë është rritur me 12.5% dhe ritmi i rritjes së saj është përsheptuar gjatë vitit. Kredia ndaj sektorit privat udhëheq rritjen në kredinë totale, duke u rritur me 16% në terma vjetorë dhe kryesisht për qëllime investimi, por edhe kredia ndaj konsumatorëve familjarë është përsheptuar në muajt e fundit duke arritur një rritje prej 5.4% në korrik 2011 (në terma vjetorë). Sektori bankar është mjaft likuid, gjë kjo e reflektuar edhe në ankandet e fundit të bonove të thesarit (yield-et më të ulta dhe ofertë më e lartë nga bankat). Megjithatë, niveli e kredive me probleme ende mbetet një problem në sektorin financiar. Niveli i tyre arriti në 16.6% në tremujorin e dytë të 2011-s nga niveli prej 13.6% në fundin e 2010-s. Në të njëjtën kohë, kjo është shoqëruar me rritje të nivelit të provigjioneve të mbajtura nga bankat në nivelin e 9.7% të totalit të kredive nga 8.2% që ishte në fundin e vitit 2010. Ndërkohë, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit mbetet në nivel mjaftueshmërisht të sigurt prej 14.6%, mbi minimumin e kërkuar nga Banka e Shqipërisë prej 12%.



Ndryshe nga zhvillimet në kursin e këmbimit në vitin 2010, zhvlerësimi i lekut gjatë kësaj periudhe të vitit 2011 ishte i moderuar. Stabiliteti i lekut gjatë kësaj periudhë reflektohet nga qëndrueshmëria në bilancin ofertë-kërkesë në tregjet monetare, stabilizimin e pritjeve në vlerën e monedhës kombëtare dhe të tkurrjes së bilancit tregtar.

Gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2011, leku është zhvlerësuar kundrejt euros me rreth 2.1%, duke arritur pikën maksimale të këmbimit me 142.64



lekë/euro më 7 qershor 2011, nga 138.8 lekë/euro që ishte në 31 dhjetor 2010, si dhe në të njëjtën kohë leku është vlerësuar me rreth 4.5% kundrejt dollarit amerikan. Zhvillimet në kursin e këmbimit pasqyrojnë edhe dinamikën në tregjet e monedhave ndërkombëtare.

Zhvillimet e fundit fiskale

Nga të dhënat e Thesarit të Ministrisë së Financave, për tetëmuajorin e parë të vitit 2011 të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 210.9 miliardë lekë (shih tabelën 1) Të ardhurat totale buxhetore ishin 1.5 për qind më të ulëta se parashikimi dhe 2.2 për qind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet totale arritën në 242.1 miliardë lekë (shih tabelën 1), 1.4 për qind më të ulëta se planifikimi dhe 3.2 për qind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet korente janë rritur mbi baza vjetore me 1.0 për qind, ndërsa shpenzimet kapitale me 5.6 për qind.

Deficiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në këtë tetëmuajor në 31.2 miliardë lekë, 0.1 miliard lekë më shumë se planifikimi, dhe 8.3 miliardë më i lartë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Deficiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brendshme (kryesisht huamarrje): 337 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuar për financimin e deficitit; 29.5 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brendshme neto. Financimi i huaj neto i deficitit ka qenë në nivelin 7.2 miliardë lekë, ose 12 milionë më shumë se planifikimi.

Tabela 1. Treguesit kryesorë të buxhetit të konsoliduar për periudhën janar-gusht

Miliardë lekë	Janar-gusht '10	Janar-gusht '11	Planifikimi 2011
Te ardhurat totale	206.1	210.9	213.8
Shpenzimet Totale	229.3	242.1	245.5
Nga të cilat: shpenzimet korente	192.2	199.6	198.6
Nga të cilat: shpenzimet kapitale	40.2	42.5	44.1
Balanca fiskale	- 23.2	-31.2	-31.6
Balanca primare	+ 3.4	-5.3	-4.8

Sipas nivelit të qeverisjes, në buxhetin e konsoliduar, të ardhurat e qeverisë qendrore përbejnë për këtë periudhë 71.2 për qind të të ardhurave gjithsej; të ardhurat e qeverisjes lokale (nga taksa dhe tarifa) vetëm 3.8 për qind; ndërsa të ardhurat e fondeve speciale rreth 18 për qind të të ardhurave gjithsej në buxhetin e konsoliduar.

Nga këndvështrimi i klasifikimit ekonomik të të ardhurave, të dhënat tregojnë se Shqipëria ka një sistem tatimor që takson më shumë konsumin kundrejt të ardhurave dhe pasurisë, dhe ky tipar ka ardhur duke u theksuar vitet e fundit. Të ardhurat nga tatimet mbi të ardhurat dhe pasurinë së bashku përbejnë 17 për qind të të ardhurave gjithsej, ndërsa të ardhurat që mbledhen nga taksimi i konsumit (TVSH dhe akcizë) përbejnë gati gjysmën (47.7 për qind) të të ardhurave të buxhetit të konsoliduar.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 99.4 për qind ndaj parashikimit, ose rreth 150.1 miliardë lekë nga afërsisht 151 miliardë lekë të planifikuara, dhe 4 për qind më shumë se 8-mujori i një viti më parë; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 8.1 miliardë lekë nga 9.1 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar të vitit 2011 dhe me rritje vjetore prej 1.8 për qind; të ardhurat në fondet speciale arritën 37.3 miliardë lekë nga rreth 37.7 miliardë lekë të planifikuara, dhe kundrejt 35.5 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore 5.1 për qind; të ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 1.7 miliardë lekë nga rreth 2 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat jotatimore kanë qenë për këtë periudhë 13.6 miliardë lekë nga 16.3 miliardë të një viti më parë, me rënie vjetore -16.3 për qind dhe realizim të planit të rishikuar prej 102.3 për qind.

Sipas agjencive të mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur 80.5 miliardë lekë, 1.4 për qind më shumë se parashikimi në buxhetin e rishikuar për 2011, dhe me rritje 4.6 për qind kundrejt 8-mujorit të parë të vitit 2010. Sipas zërave të të ardhurave që mbledhin doganat, bie në sy performanca e

rentës minerare në eksport, që është rritur mbi baza vjetore me rreth 70.9 për qind, kryesisht, si pasojë e rritjes së eksporteve të burimeve natyrore, si dhe ndryshimeve në normën e taksimit dhe në strukturën e taksës gjatë gjysmës së parë të vitit 2010. Të ardhurat nga akciza në dogane rezultojnë me rënie prej 4.9 për qind kundrejt një viti më parë. Të ardhurat nga TVSH në import janë 6.4 për qind më të larta se një vit më parë dhe 1.9 për qind më shumë se parashikimi për periudhën sipas buxhetit të rishikuar. TVSH në doganë ka pasur ecuri pozitive veçanërisht gjatë muajit gusht, me rritje vjetore rreth 14 për qind.

Te ardhurat në dogana sipas muajve dhe krahasimi me 2010-n

Dogana total 2011	Muaji (miliardë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Ne % ndaj 2010-s
Janar	8.1	-34.3	13.4
Shkurt	8.2	1.3	9.9
Mars	9.5	16.2	-3.4
Prill	9.4	-1.3	-3.6
Maj	9.9	5.7	-4.8
Qershor	11.1	12.3	8
Korrik	11	-1.4	2.3
Gusht	13.3	21.3	17.6

Administrata tatimore ka mbledhur 4.3 për qind më shumë të ardhura se 8-mujori i vitit 2010 ose 4.3 miliardë lekë më shumë (përfshirë dhe kontributet) për një total prej 103.7 miliardë. Totali i të ardhurave tatimore ka pasur një rritje prej 3.3 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ndërsa të ardhurat nga kontributet janë rritur me 6.4 për qind mbi baza vjetore. Administrata tatimore ka rezultate të mira në mbledhjen e tatim fitimit, akcizës dhe taksave nacionale për këtë periudhë krahasuar me një vit më parë.

Te ardhurat në tatime sipas muajve dhe krahasimi me 2010-n (pa kontributet)

Tatime total 2011	Muaji (miliardë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010-n
Janar	9.0	-2.8	7.0
Shkurt	7.8	-13.9	8.4
Mars	10.7	37.6	17.0
Prill	7.7	-28.0	-4.1
Maj	9.2	19.4	15.8
Qershor	8	-12.4	-2.6
Korrik	8.7	7.9	-1.2
Gusht	8.4	-3.4	-11.9

TË ARDHURAT NGA TAKSIMI I KONSUMIT

Tatimi mbi vlerën e shtuar

Nga TVSH janë mbledhur gjithsej për 8-mujorin 74.4 miliardë lekë, ose 0.4 për qind më shumë se një vit më parë dhe 0.5 për qind më shumë se parashikimi në buxhetin e rishikuar për vitin 2011.

Tatimi mbi vlerën e shtuar në vite për tetëmuja

EMËRTIMI	2008	2009	2010	2011
Tatimi mbi vlerën e shtuar total (milion lekë)	68,206	71,136	74,091	74,387
Tatimi mbi vlerën e shtuar total (në %)		23.2	4.3	4.2
Tatimi mbi vlerën e shtuar dogana (milion lekë)	47,543	48,963	54,693	58,211
Tatimi mbi vlerën e shtuar dogana %		3%	11.7%	6.4%
Tatimi mbi vlerën e shtuar tatime (milion lekë)	20,663	22,173	19,398	16,176
Tatimi mbi vlerën e shtuar tatime %		7.3%	-12.5%	-16.6%



Nga administrata doganore janë mbledhur 58.2 miliardë lekë TVSH mbi mallrat e importuar, duke realizuar planin e periudhës në masën 101.4 për qind. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 78 për qind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë të jenë 3.5 miliardë lekë më shumë ose 6.4 për qind më shumë. Në vijim analizojmë faktorët kryesorë me ndikim në të ardhurat e mbledhura nga Dogana.

Është rritur mbi baza vjetore vlera e importeve për periudhën janar-gusht, në masën 14.3 për qind, e ndikuar kryesisht nga zëri “karburante”, siç shpjegohet pak më poshtë. Kapitujt e tjerë kryesorë të mallrave me kontribut pozitiv në rritjen e importeve ishin: drithërat, disa metale bazë (si: giza dhe çeliku), makineri dhe pajisje mekanike dhe mjete transporti. Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave tregojnë rënie të importeve të produkteve si: fruta dhe zarzavate, duhani dhe nënproduktet e tij, disa lloj materialeve ndërtimi etj.

Muaji gusht u karakterizua nga një rritje e ndjeshme e arkëtimeve nga importi i karburanteve. Shifrat e marra nga të dhënat e DPD-së tregojnë për muajin gusht një vlerë importi për benzinën 1.4 miliardë lekë (55.5 % më shumë se gushti i vitit 2010) dhe 5.9 miliardë lekë vlerë importi për gazoilin (85% më shumë se gushti i vitit 2010) Kjo ecure është edhe rezultat i reagimit të subjekteve importuese të karburanteve ndaj ndryshimeve të fundit ligjore që preken disa nga taksat nacionale, konkretisht vendosja e taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin që rrit barrën fiskale mbi importin dhe prodhimin e këtyre artikujve. Ndryshimet në fjalë hyjnë në fuqi në fund të muajit gusht 2011. Në tabelën që vijon paraqiten të dhënat e importit për benzinën dhe gazoilin gjatë 2010 dhe 2011-s.

Importe	Benzinë			Gazoil		
	Sasi (000/litra)	Vlera (mln lekë)	Taksa të paguara (mln lekë)	Sasi (000/litra)	Vlera (mln lekë)	Taksa të paguara (mln lekë)
Janar-gusht 2010	73,515	4,414	4,204	312,217	19,574	18,182
Janar-Gusht 2011	80,806	6,381	4,929	246,191	20,511	15,316
Gusht 2010	15,763	914	906	49,938	3,172	2,997
Gusht 2011	17,465	1,371	1,077	72,088	5,935	4,604

Për këtë periudhë është evidentuar me ndikim në të ardhurat nga TVSH në doganë aplikimi nga subjektet përfitues të skemës së shtyrjes së TVSH-së në importin e makinerive dhe pajisjeve për investim, në shumën 2.4 miliardë lekë nga 1.9 miliardë të tetëmuajorit të vitit 2010, ose 473 milionë lekë më pak të arkëtuara si pasojë e aplikimit të skemës. Vlen të theksohet se një pjesë është përfituar nga subjekte shtetërore siç është operatori i sistemit të transmetimit. Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat mbi vlerën e importit për 8-mujorin të makineri-pajisjeve për vitet 2007-2011, për të cilat aplikohet shtyrja e TVSH-së në import për një vit ose më shumë, si dhe vlera e TVSH-së së shtyrë.

Kapitulli	2007	2008	2009	2010	2011
84 (makineri, pajisje) (mln lekë)	20,360	22,102	24,771	20,974	27,720
85 (makineri, pajisje) (mln lekë)	12,866	18,014	21,002	22,820	23,280
87 (mjete transporti) (mln lekë)	16,309	16,354	17,660	15,792	14,139
Total (mln lekë)	49,535	56,470	63,433	59,586	65,138
Total importi (mln lekë)	236,889	278,276	271,939	306,314	349,995
Makineri pajisje ne % ndaj totalit	21	20	23	19	19
TVSH e shtyrë (mln lekë)		1,020	1,841	1,897	2,370

Së fundi përmendim efektin në të ardhura nga ndryshimi i kursit të këmbimit për periudhën janar-gusht kemi zhvlerësim të lekur ndaj euros në masën 2%, ndërsa kundrejt dollarit leku rezultoi i forcuar me rreth 4,7%, çka ndikon në vlerën e importeve të disa artikujve me peshe të lartë specifike në

totalin e importit, siç janë karburantet, kuotimi i të cilave në bursat e tregjeve ndërkombëtare bëhet në dollar amerikan.

Nga administrata tatimore për periudhën janar-gusht janë mbledhur 16.2 miliardë lekë TVSH nga 16.9 miliardë lekë të planifikuara sipas buxhetit të rishikuar 2011, që do të thotë 4.2 për qind më pak se parashikimi dhe 16.6 për qind më pak se një vit më parë. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 22 për qind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja.

Rimbursimi i TVSH-së për periudhën 8-mujore ka arritur shifrën 4.4 miliardë lekë nga 3.9 miliardë që ishte një vit më parë, me rritje 12.1 për qind, siç pasqyrohet në tabelën në vijim.

Milionë lekë	2010	2011	Ne % ndaj 2010
TVSH e arkëtuar (bruto)	23.3	20.6	-11.7
TVSH neto	19.4	16.2	-16.6
Rimbursimi faktik i paguar	3.9	4.5	+12.1

Sipas strukturës të të ardhurave tatimore që mbledh administrata tatimore, në vitin 2010 për 8- mujorin TVSH zinte rreth 28.8% të totalit të të ardhurave, ndërsa për 8-mujorin e vitit 2011 kjo peshë është ulur ndjeshëm në 23.4% të totalit të të ardhurave.

Tabela në vijim pasqyron të ardhurat e TVSH-së sipas sektorëve për tetëmujorin 2010/2011 dhe numrin e subjekteve pagues.

Emërtimi	8-mujor 2010 (mln lekë)	8-mujor 2011 (mln lekë)	Ndryshimi në %	Subjekte paguese 2010	Subjekte paguese 2011	Ndryshimi në %
Prodhim	4,913	5,018	2.1%	1,208	1,226	1.5%
Ndërtim	5,508	3,455	-37.3%	1,707	1,767	3.5%
Transport	264	301	14.0%	311	297	-4.5%
Tregti	2,533	2,674	5.5%	3,258	3,349	2.8%
Shërbime	6,195	4,737	-23.5%	2,255	4,537	101.2%

Gjatë vitit 2011 struktura e TVSH-së pësoi disa ndryshime, me vendosjen e normës së reduktuar 10% mbi shërbimet shëndetësore dhe barnat (efekt i përafërt në të ardhura për vitin 2011 rreth 1.2 miliardë lekë deri në gusht), si dhe heqjen e pragut të regjistrimit për profesionet e lira.

Akciza

Të ardhurat gjithsej nga akciza për periudhën janar-gusht arritën në rreth 26.2 miliardë lekë ose 0.4% më shumë se parashikimi sipas planit në buxhetin e rishikuar, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga kjo taksë janë rritur në masën 3.2 për qind. Akciza pësoi ndryshime të ndjeshme në qershor të vitit 2010: u ul akciza mbi kafën e papjekur (nga 70 lekë në 30 lekë për kg), u hoqën nga lista e mallrave me akcizë lëngjet e frutave dhe pijet freskuese, në grupin e nënprodukteve të naftës shtohet artikulli “naftë *virgin*” me nivel akcize 50 lekë për litër; u shtuan në listën e mallrave me akcizë: fishekzjarrët, gomat, pilat dhe bateritë primare, ambalazhet; ndryshoi taksimi i llambave inkandeshente nga *ad valorem* në shumë fikse. Në fillim të vitit 2011 pati rritje të akcizës mbi cigaren, nga 50 lekë në 70 lekë për paketë.

Të ardhurat nga akciza për 8-mujorin 2008-2011, sipas agjencive të mbledhjes

	8-mujor 2008	8-mujor 2009	8-mujor 2010	8-mujor 2011
Akciza gjithsej (mld lekë)	21,8	22,5	25,4	26,2
Ndryshimi vjetor %	21.1	3.2	12.8	3.2
Doganë	13.4	13.2	16.4	15.6
Tatime	8.4	9.3	9	10.6



Të ardhurat nga akciza që mbledhin doganat janë ulur me 4.9 për qind kundrejt një viti më parë por janë 1.7 për qind më shumë se parashikimi për periudhën. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birrës së importuar, si dhe të mallrave të tjerë që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës (siç janë mallrat që i janë shtuar listës së mallrave të akcizës). Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata e zhdoganimeve për periudhën ka qenë si vijon (për karburantet folëm me lart):

- Sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën janar-gusht 2011 është 1,937 tonë, me rënie vjetore prej -24.8 për qind. Rënia e importeve të cigares për këtë vit është shkaktuar pjesërisht nga shtimi i importeve në muajt e fundit të 2010-s, para hyrjes në fuqi të rritjes së akcizës;
- Sasia e birrës së zhdoganuar për periudhën janar-gusht 2011 është 22.5 milionë litra, me një rënie prej 12.6 për qind, e ndikuar edhe nga rritja e prodhimit vendas të këtij artikulli;
- Kafeja e zhdoganuar për periudhën 8-mujore ka qenë 13 për qind më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Nga administrata tatimore janë mbledhur nga akciza rreth 10.6 miliardë lekë, me rritje vjetore 17.8 për qind dhe realizim të planit të rishikuar në masën 98.5 për qind. Tatimet mbledhin akcizën mbi cigaret dhe pijet alkoolike përveç birrës, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vend (ARMO).

Te ardhurat nga akciza për 8-mujorin sipas produkteve kryesore

Të ardhura, milionë lekë	8-mujor 2010	8-mujor 2011	Ndryshimi %
Total	25,391	26,199	+3.2
Akciza mbi cigaret	7,557	7,075	-6.4
Akciza pije alkoolike vendi	361	380	+5.3
Akciza pije alkoolike importi	918	842	-8.3
Akciza karburant vendi	1,128	3,025	+168
Akciza karburant importi	14,504	12,939	-10.8
Të tjera	923	1,938	+110

TË ARDHURAT NGA TAKSIMI DIREKT

Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 18.3 miliardë lekë për periudhën janar-gusht, me rritje 4.6 për qind në krahasim me 8-mujorin e një viti më parë dhe me realizim të planit të rishikuar për vitin 2011 në masën 99 për qind. Sipas komponentëve të këtij tatimi, situata e të ardhurave të mbledhura këtë vit dhe krahasimi me 2010-n jepet në tabelën më poshtë.

Të ardhura, miliardë lekë	8-mujor 2010	8-mujor 2011	Ndryshimi %
Tatimi mbi të ardhurat personale gjithsej	17.6	18.3	+3.8
Paga sektori publik	5.5	5.85	+6.3
Paga sektori jopublik	5.3	5.9	+11.1
Interesa	1.8	1.9	+3.3
Dividendë	1.15	1.23	+6.9
Shitje pasuri e paluajtshme	1.5	1.1	-27.8
Të tjera	2.0	2.0	0.0

Përveç tatimit mbi shitjen e pasurive të paluajtshme, të gjithë zërat e TAP-it kanë ecuri shumë pozitive të të ardhurave krahasuar me një vit më parë, veçanërisht zëri i tatimit mbi pagën, që mbi baza vjetore është rritur me gati 10 për qind, çka tregon rritje të indikatorit “wage bill”, që ndikohet nga niveli i punësimit dhe niveli i pagave, domethënë ecuri në rritje të aktivitetit ekonomik në vend. Në këtë

aspekt performancën më të mirë e ka pasur sektori prodhues, pasuar nga sektori i shërbimeve (për sa i takon sektorit privat). Subjektet e sektorit privat që kanë deklaruar dhe paguar (në burim) TAP për tetëmujorin e këtij viti janë 25,257 krahasuar me 23,939 të periudhës tetëmujore të një viti më parë.

Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 8-mujorin 2011, arritën në rreth 14 miliardë lekë nga 11.7 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rritje të ndjeshme prej 19.7 për qind, dhe në linjë me planin e rishikuar.

Tatimfitimi, 2011	Muaji (milionë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2010-s
Janar	1,302	-22.5	23.9
Shkurt	1,113	-14.5	-10.1
Mars	3,973	+257	38.9
Prill	1,319	-66.8	10.0
Maj	2,289	+73.5	104.1
Qershor	1,316	-42.5	13.0
Korrik	1,237	-6.0	10.2
Gusht	1,413	14.2	-26

Ne rezultatin e të ardhurave për tatim fitimin për këtë vit ka ndikuar derdhja e tatimfitimit nga KESH në muajin maj për bilancin e vitit 2010, në shifrën 1,147 milionë lekë. Edhe për sektorin privat, kemi një rezultat mjaft të mirë krahasuar me vitin e kaluar. Arkëtimet e muajit mars gjatë të cilit bëhen derdhjet e tatim fitimit bazuar në bilancet për vitin paraardhës për vitin 2011 janë rreth 39 për qind më të larta se marsi i vitit 2010-s. Situata rezulton me e mire në sektorin publik të prodhimit, ku përfshihet pikërisht elektron-energjetika (KESH) dhe sektori i karburanteve (Albpetrol, me pagesë tatimfitimi 110 milionë lekë).

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 2.1 miliardë lekë, me rritje vjetore prej 21.4 për qind duke qene 64.8 për qind më lart se parashikimi sipas buxhetit të rishikuar. Subjektet tatimpagues të taksës vendore të biznesit të vogël kanë pësuar rënie për periudhën (me rreth 2100 njësi m, sipas shifrave të shtatëmujorit) kundrejt një viti më parë. Shifra 2.1 miliardë lekë nuk përfshin vlerën e taksës që nuk është mbledhur për rimbursimin e çmimit të kasave. Kjo vlerë rimbursimi arrin në rreth 465 milionë lekë, të përballuara nga fondi i kontingjencës së parashikuar në buxhetin e vitit 2011.

Taksimi i pasurisë

Për qëllime analize, këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat, mbi tokën bujqësore dhe taksën e kalimit të pasurisë së paluajtshme. Është prej kohësh një pjesë problematike e sistemit tatimor, për sa i takon të ardhurave të mbledhura kundrejt të ardhurave potenciale që mund të mbledhen nga pasuria e paluajtshme. Administrimi dhe grumbullimi i taksës mbi pasurinë rezulton të jetë përgjithësisht efektiv për sa i përket bizneseve dhe institucioneve/organizatave dhe ndjek të njëjtën tendencë në arritjen e nivelit të parashikuar të të ardhurave me taksat dhe tarifat e tjera të aplikueshme nga njësitë vendore (tarifat e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit). Ndërkohë, eksperiencia nuk është e njëjtë për kategorinë “Familjare” të taksapaguesve. Këtu tendenca në grumbullimin e kësaj takse është e ulët, dhe njësitë e qeverisjes vendore kanë mjaft probleme në administrim dhe në detyrimin për pagimin e taksës. Për nivelin ende të lartë të informalitetit, ka mjaft vështirësi në vlerësimin e bazës së taksueshme, për arsye të mangësive në deklarimin real të pasurive. Për 8-mujorin taksat mbi pasurinë arrijnë në 1.3 miliardë lekë nga 2 miliardë të parashikuara, dhe 104 milionë lekë ose 7.3 për qind më të ulëta se një vit më parë. Në tabelën në vijim pasqyrohet taksimi i pasurisë në 4 vitet e fundit për periudhën tetëmujore.

8-mujori, mln lekë	2008	2009	2010	2011
Taksimi i tokës bujqësore	314	231	258	188
Taksimi i ndërtesave	792	857	1,022	933
Taksa e kalimit të pronësisë	226	163	120	166
Total taksimi i pronësisë	1,332	1,251	1,400	1,287
Ndryshimi vjetor në %		-6.1	+11.9	-8.1



TAKSA DHE TATIME TË TJERA

Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale në total për periudhën, janë 12.8 miliardë lekë nga 13.2 miliardë lekë të parashikuara për periudhën janar-gusht. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash kanë pësuar një rritje prej 14.9 përqindësh.

Emërtimi (milione lekë)	8-mujori 2008	8-mujori 2009	8-mujori 2010	8-mujori 2011	2011/2010
Taksat nacionale gjithsej, nga të cilat	9,696	8,423	11,143	12,803	+14.9
Transaksionet e mjeteve të përdorura	1,698	1887	1,677	1,254	-25.2
Taksa e qarkullimit	2,560	2,887	2,926	2,614	-10.7
Taksa e karbonit	382	340	589	1,338	+127.3
Renta minerare, nga të cilat	129	1,142	1,971	3,104	+57.5
- Në dogane	0	447	1,280	2,187	+70.9
- Në tatime	129	695	691	917	+32.7
Kazinotë dhe lojërat	1,330	2,048	3,404	3,342	-1.8

Rritje të konsiderueshme vjetore ka pasur taksa e karbonit me 749 milionë lekë më shumë ose 127.3 për qind dhe renta minerare me gati 1 miliardë lekë më shumë (ku kontributin kryesor në rritje e ka renta e mbledhur në doganë burimet e eksportuara, me 907 milionë lekë më shumë se një vit më parë). Disa nga taksat e grupit të taksave nacionale kanë pësuar ndryshime në strukturë dhe nivel, gjatë vitit 2010 dhe 2011. Kështu, me ndryshimet e ligjit për taksat kombëtare që u bënë në muajin maj të vitit 2010 u vendos taksa mbi transaksionet e mjeteve të përdorura që zgjeroi taksimin edhe mbi transaksionet brenda vendit përveç se në import, por pa efekte pozitive mbi të ardhurat e mbledhura (madje për periudhën tetëmuajore kemi rënie vjetore prej 25 për qind), për shkak të reduktimit të transaksioneve për shmangien nga taksimi; pati rritje të nivelit të taksës së karbonit, nga 0.5 lekë dhe 1 lekë për benzinën dhe gazoilin në 1.5, 3 dhe 3 lekë përkatësisht për benzinën, gazoilin dhe qymyrin, çka ka sjellë dhe efektet pozitive mbi të ardhurat e përmendura më lart; për disa nga mineralet e shtojcës 2 të ligjit të taksave kombëtare pati rritje të nivelit të rentes minerare. Meqenëse këto ndryshime kanë hyrë në fuqi në gjysmën e dytë të vitit 2010, efekti i tyre ndikon mbi të ardhurat e periudhës që po analizojmë krahasimisht me vitin e kaluar.

Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën janar-gusht janë rreth 4.5 miliardë lekë, 5.5 për qind më pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2010, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 69 milionë lekë, ose -1.5 për qind. Niveli mesatar i taksës doganore për këtë periudhë është 1.59 për qind nga 1.74 për qind në vitin 2010, duke kontribuar kështu dhe në uljen e të ardhurave nga taksat doganore.

Të ardhura të tjera nga pushteti vendor

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën janar-gusht arritën në 8.1 miliardë lekë nga 9.1 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin 2011, ndërsa kundrejt 8-mujorit të parë të vitit 2010 të ardhurat janë rritur me 143 milionë lekë (rreth 1.8 për qind). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogël dhe taksat mbi pasurinë për të cilat folëm më lart) kanë mbledhur rreth 4.7 miliardë lekë nga 5.8 miliardë të parashikuara për periudhën; krahasuar me të njëjtën periudhë me vitin e kaluar të ardhurat nga këto taksa kanë pësuar një ulje të lehtë -2.7 për qind.

Të ardhurat e fondeve speciale

Të ardhurat në fondet speciale për periudhën janar-gusht 2011 arritën në 37.4 miliardë lekë, me një rritje prej 5.1 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe -1.1 për qind më pak se parashikimi sipas buxhetit të rishikuar. Ky grup të ardhurash përbën rreth 19 për qind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, 36.2 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 1.1 miliardë lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 32.1 miliardë lekë, me rritje vjetore 7.4 për qind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 4 miliardë lekë, -6.4 për qind më pak se 8-mujori i një viti më parë.

Për sa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat paraprake të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 8-mujore rezultoi se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektori shtetëror dhe sektori privat) prej 9.5 përqindësh, ose rreth 37.3 mijë njësi, kundrejt mesatares 8-mujore të 2010 nga ku sektori i tregtisë dhe shërbimeve zënë pjesën kryesore përkatësisht 19.8 mijë njësi dhe 15.5 mijë njësi. Në tabelat më poshtë pasqyrohen të dhënat lidhur me numrin mesatar mujor progresiv të kontribuesve të sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësore për pjesën që administrojnë administrata tatimore dhe ndarjen e të ardhurave nga kontributet që mbledhin tatimet sipas sektorëve të ekonomisë.

Numri i kontribuesve sipas sektorëve të punësimit

	8-mujor 2010	8-mujor 2011	Ndryshimi në %
Ndërmarrjet buxhetore	131,806	140,784	6.8%
Ndërmarrjet shtetërore	22,303	22,116	-0.8%
Subjektet private TVSH	172,166	183,528	6.6%
Subjektet biznesit vogël	66,292	83,432	25.9%
Total	392,567	429,860	9.5%

Të ardhurat nga kontributet sipas sektorëve të ekonomisë

Emërtimi	8-mujor 2010 (mln lekë)	8-mujor 2011 (mln lekë)	Ndryshimi në %	Subjekte paguese 2010 (punëdhënës)	Subjekte paguese 2011 (punëdhënës)	Ndryshimi në %
Kontribute gjithsej	32,000	34,098	+6.6	74,748	75,103	+0.5
Prodhim	4,743	4,808	+1.4	7,593	7,672	+1.0
Ndërtim	2,075	2,018	-2.7	3,337	3,372	+1.1
Transport	812	842	+3.6	6,836	6,617	-3.2
Tregti	4,116	4,269	+3.7	29,249	28,331	-3.1
Shërbime	20,254	22,162	+9.4	27,733	29,111	+5

Kuadri makroekonomik afatmesëm

Parashikimi i treguesve makroekonomikë afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërëse të kuadrit makroekonomik është bazuar në teknikat analitike të programimit financiar. Për këtë qëllim janë ndërtuar disa skenarë të mundshëm të ecurisë makroekonomike të vendit, rezultatet e të cilëve i janë nënshtruar një analize krahasuese të hollësishme për të arritur në skenarin bazë makroekonomik. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik, mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukture qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të aktorëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili duket si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, të cilat paraqiten në tabelat respektive të aneksit, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të prodhuara prej institucioneve si, Instituti i Statistikave, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Eurostat, Banka Qendrore Europiane etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, testimit, analizat krahasuese, statike, dinamike, e pasi kryhen një sërë testesh konsistence, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme e maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale. Objektivat themelore të miksit të politikave monetare e fiskale gjatë tri viteve në vijim me anë të të cilëve synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimit sa më të shpejtë drejt nivelit mesatar të mirëqenies së Bashkimit Europian, janë:



- Mbajtja e normës së inflacionit rreth nivelit 3 për qind dhe brenda fashës së tolerancës 2% – 4%;
- Mbajtja e deficitit fiskal në nivelin 3% të PBB-së për periudhën 2012- 2014 (në përputhje me rekomandimet e KE-së për përmbushjen e kriterëve ekonomike të Kopenhagenit dhe në linjë me kriteret e Mastroitit);
- Mbajtja e borxhit publik poshtë nivelit 60%, si dhe ulja graduale e tij (në përputhje me rekomandimet e KE-së për përmbushjen e kriterëve ekonomike të Kopenhagenit dhe në linjë me kriteret e Mastroitit);
- zbutja e deficitit të llogarisë korente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë, duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore për të financuar rreth 5 muaj importe mallrash e shërbimesh në vitin 2013.

Këta objektiva fundamentale përbëjnë konturet bazë të kuadrit makroekonomik e fiskal brenda të cilave përcaktohen projeksionet për të gjitha variabëlët e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten projeksionet për treguesit kryesorë makroekonomikë për periudhën 2012-2014.

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2007	2008	2009	2010	2011 Para.	2012 Para.	2013 Para.	2014 Para.
Popullsia	Milion	3.16	3.17	3.18	3.19	3.21	3.22	3.23	3.23
Norma e inflacionit (mesatar)	%	2.9	3.4	2.3	3.6	3.5	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	3.6	4.7	2.3	2.5	2.7	1.6	1.5	1.5
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	90.4	83.9	95.0	103.9	100.5	102.0	102.5	104.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	123.9	122.8	131.6	137.8	139.1	139.0	139.2	139.2
Rritja reale e PBB	%	5.9	7.5	3.3	3.8	5.0	5.1	5.0	5.2
PBB	Lek miliardë	967.7	1,089.3	1,151.0	1,224.9	1,319.8	1,408.9	1,501.7	1,602.0
PBB	USD miliardë	10.7	13.0	12.1	11.8	13.1	13.8	14.7	15.4
PBB	Euro miliard	7.8	8.9	8.7	8.9	9.5	10.1	10.8	11.5
PBB për banor	Lek mijë	306.0	343.8	361.4	383.4	411.7	437.9	465.1	495.6
PBB për banor	USD	3,384.3	4,098.6	3,804.9	3,689.3	4,096.4	4,293.4	4,537.5	4,765.4
PBB për banor	Euro	2,470.5	2,800.8	2,746.5	2,782.8	2,959.7	3,150.6	3,341.2	3,561.6
PBB për banor	USD-PPP	7,116.9	7,996.3	8,405.2	8,917.0	9,574.2	10,184.4	10,816.2	11,525.6
Norma e papunësisë	%	13.2	12.7	13.8	13.3	12.7	11.6	10.4	9.3
Llogaria korente	% të PBB	-10.6	-15.5	-15.5	-11.9	-11.5	-10.2	-9.1	-7.9
Bilanci i mallrave	% të PBB	-26.9	-27.4	-26.5	-23.5	-21.5	-19.1	-17.7	-16.3
Bilanci i shërbimeve	% të PBB	0.2	0.8	1.4	2.2	3.0	3.0	3.6	3.8
Bilanci i Pagesave	% të PBB	1.9	2.2	-0.4	0.7	1.2	2.4	3.4	3.3

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

Politikat tatimore dhe parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme

Disa nga politikat tatimore të hartuara/miratuara gjatë vitit 2011 do të fillojnë të ushtrojnë efektin e tyre gjatë vitit 2011. Të tilla janë:

Vendosja e deklarimit integral për të ardhurat individuale. Viti i parë i deklarimit do të jetë viti 2012 për të ardhurat e realizuara në vitin 2011. Viti 2011 është vit përgatitjesh për fillimin e zbatimit të kësaj forme deklarimi dhe pagimi të tatimit mbi të ardhurat personale. Hartimi i këtij ndryshimi në ligjin tonë mbi të ardhurat u realizua me asistencën franceze në kuadër të fondeve IPA. Për këtë fazë të parë të zbatimit, skema është me e "thjeshtë" se ajo e përdorur në shumicën e vendeve të BE-së. Nga politikëbërësit është konsideruar si mjet për formalizimin e mëtejshëm të ekonomisë, dhe nuk pritet të ketë impakt të rëndësishëm mbi të ardhurat, të paktën për vitet e para të zbatimit. Skema parashikon disa kategori shpenzimesh të zbritshme, për të ardhura që nuk kalojnë një prag të caktuar. Detyrimi i deklarimit nuk është lidhur me moshën por me statusin ekonomik aktiv të individit.

Në strukturën e tatimit mbi vlerën e shtuar është vendosur tarifë e reduktuar 10% për shërbimet e shëndetësisë (publike dhe private) dhe furnizimi i barnave është furnizim i tatueshëm me 10%. Ndryshimi hyri në fuqi në fillim të vitit 2011.

Pullat fiskale. Ka përfunduar hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor të koncesionit të pullave të akcizës dhe pullave fiskale dhe projekti ka hyrë në fazën e zbatimit. Data efektive e hyrjes në fuqi të sistemit të ri është muaji mars 2012.

Ndryshime ka pësuar dhe akciza gjatë vitit 2011. Me efekt nga fundi i gushtit 2011, ndryshoi struktura e taksimit të birrës, duke shtuar intervalet e taksimit sipas sasisë vjetore të prodhuar/importuar dhe duke ulur barrën fiskale për këtë produkt). Efekti në ulje i të ardhurave që pason këtë politike pritet të kompensohet me rritjen e deklarimeve të sasive të prodhuara nga prodhuesit e mëdhenj vendas të birrës pas aplikimit të skemës së re të pullave fiskale mbi produktet e birrës. U rrit në 37 lekë/kg akciza për lëndët djegëse “solar, mazut”, me efekt të pritshëm për vitin 2012 rreth 340 milionë lekë më shumë; u rrit akciza për produktin “koks naftë” në 2 lekë/kg, me efekt të pritshëm për të ardhurat në 2012-n rreth 190 milionë lekë.

Ndryshime të rëndësishme pati në grupin e “taksave nacionale” me shfuqizimin e disave prej tyre dhe vendosjen e taksave të reja. U shfuqizuan “taksa e qarkullimit rrugor”, “taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve” dhe “taksa mbi transaksionet e mjeteve të përdorura”. Sipas strukturës së re, tashmë ka hyrë në fuqi “taksa vjetore e automjeteve të përdorura” dhe “taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin”. Ndryshime pati dhe në taksën e karbonit. Efekti i pritshëm në të ardhura për vitin 2012 për taksën e karbonit është rreth 775 milionë lekë, për taksën e qarkullimit rreth 4.9 miliardë lekë dhe për taksën vjetore të mjeteve të përdorura rreth 4.1 miliardë lekë.

Në lidhje me tarifën doganore, një politike e rëndësishme ishte ajo e bërjes zero të tarifës doganore për artikujt që shërbejnë si lëndë e parë në industrinë e prodhimit të veshjeve dhe këpucëve. Efekti vjetor në të ardhura për vitin 2012 pritet të jetë rreth 670 milionë lekë.

Ndryshimet e ligjeve tatimore do të vijnë drejt përafrimit me kuadrin ligjor të harmonizuar të BE-së për taksimin indirekt (TVSH dhe akcizë). Në fushën e tatimeve direkte, ndryshimet ligjore do të respektojnë parimet e vendosura në kodin e etikës europiane për taksimin e kompanive, si dhe të *Small Business Act*.

Efekte mbi të ardhurat priten dhe nga përmirësime në administrimin dhe mbledhjen e të ardhurave. Këtu elementi më i rëndësishëm është përfundimi i procesit të pajisjes me kasa regjistruese të bizneseve dhe përdorimi i tyre i rregullt për regjistrimin e transaksioneve që kryhen më para në dorë.

Bazuar në kuadrin e fundit makroekonomik për periudhën 2012-2014 dhe politikën tatimore për tri vitet në vijim, të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar për tri vitet 2012-2014, në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet 367.2, 391.7 dhe 417.7 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 6.7%, 6.7% dhe 6.6%, ndërsa në raport me PBB-në të ardhurat do jenë respektivisht 26.1% në 2012, në 26.1% e PBB-në në 2013-n dhe 26.1% e PBB-në në 2014-n.

Ecuria e të ardhurave nga tatimet dhe doganat, si zëri kryesor i të ardhurave të buxhetit të shtetit, për periudhën 2010-2012 do të karakterizohet nga një rritje me ritme të krenaqshme, mesatarisht me rreth 8 për qind, në përputhje me ecurinë e bazës së taksueshme për secilin nga zërat, ose në vlerë absolute, parashikohen të mbledhen 260,658 milionë lekë në vitin 2012, 281,612 milionë lekë në vitin 2013 dhe 304,816 milionë lekë në vitin 2014.

Të ardhurat nga TVSH-ja

Parashikimi për periudhën 2012-2014 është: 129.2 miliardë lekë për vitin 2012, 139.4 miliardë lekë për vitin 2013 dhe 151.2 miliardë lekë për vitin 2014, me rritje vjetore përkatësisht 7.7%, 7.9% dhe 8.4%. Për këtë periudhë dogana pritet të mbledhë mesatarisht rreth 74.1% të totalit të të ardhurave nga TVSH-ja. Parashikimi për TVSH nga dogana bazohet në parashikimin e nivelit nominal të importeve, si dhe në prirjen historike të koeficientit të elasticitetit të këtyre të ardhurave ndaj nivelit të importeve të mallrave. Rritja vjetore e të ardhurave nga TVSH-ja në doganë parashikohet 7% në 2012-n, 6.8% në 2013-n dhe 6.9% në vitin 2014 krahasuar me një vit më parë.

Parashikimi i të ardhurave nga TVSH-ja në tatime bazohet në nivelin e parashikuar të PBB-së nominale, në pritshmërinë e aktivitetit ekonomik për sektorë të veçantë të ekonomisë, si dhe në karakteristikat e serisë kohore të koeficienteve të elasticitetit të kësaj takse. Rritja vjetore e të ardhurave nga TVSH-ja në tatime parashikohet 9.8% në 2012-n, 11.1% në 2013-n dhe 12.9% në vitin 2014 krahasuar me një vit më parë.



TVSH-ja është tatimi më i rëndësishëm i sistemit tatimor shqiptar, për nga pesha në totalin e të ardhurave në përqindje të PBB. Raporti ndaj PBB do të mbetet i stabilizuar në tri vitet në vijim, në nivelin 9.3%.

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin

Parashikimi për periudhën 2012-2014 është: 22.7 miliardë lekë për vitin 2012, 24.7 miliardë lekë për vitin 2013 dhe 26.8 miliardë lekë për vitin 2014, me rritje vjetore përkatësisht 7.9%, 8.7% dhe 8.4%. Parashikimi për këtë zë është bazuar në parashikimin për rritjen e bazës së tatueshme, si rrjedhojë e ecurisë së PBB-së nominale, si dhe të përmirësimeve të pritshme të elementit administrativ.

Te ardhurat nga akciza

Parashikimi për periudhën 2012-2014 është: 44.6 miliardë lekë për vitin 2012, 48.2 miliardë lekë për vitin 2013 dhe 52.2 miliardë lekë për vitin 2014, me rritje vjetore përkatësisht 8.1%, 8.1% dhe 8.3%. Për këtë periudhë dogana pritet të mbledhë mesatarisht rreth 60% të totalit të të ardhurave nga akciza. Te ardhurat nga akciza në doganë ndikohen direkt nga sasitë e importuara të mallrave të forta. Elementi tjetër që është mbajtur në konsideratë është ai i ndryshimit të politikës tatimore për këtë taksë. Gjatë vitit 2010 listës së mallrave me akcizë iu shtuan produkte të reja, përdorimi i të cilave ka ndikim ambiental, si dhe u rrit akciza e cigares. Lidhur me administrimin pritet që vendosja dhe funksionimi i platformës së re të pullave fiskale do të ushtrojë ndikim mbi uljen e evazionit për këtë taksë dhe ky efekt do të ndihet plotësisht duke filluar nga viti 2012. Rritja vjetore e të ardhurave nga akciza në doganë parashikohet në nivelet 6.7%, 6.5% dhe 6.6%, përkatësisht për vitet 2012, 2013 dhe 2014.

Në të ardhurat nga akciza të parashikuara për tatimet, elementi administrativ që përmendëm më lart do ketë efekt dominues. Rritja vjetore e të ardhurave nga akciza në tatime parashikohet në 10.3, 10.5 dhe 10.8% për vitet 2012, 2013 dhe 2014.

Ne raport me PBB-në të ardhurat nga akciza pritet të jenë në nivele të pandryshuara 3.2 deri në 3.3% të PBB.

Tatimi mbi të ardhurat personale

Parashikimi për periudhën 2012-2014 është: 33.8 miliardë lekë për vitin 2012, 34.6 miliardë lekë për vitin 2013 dhe 37.4 miliardë lekë për vitin 2014, me rritje vjetore përkatësisht 8.1%, 8.7% dhe 8.2%. Parashikimi është ndikuar nga ecuria e deritanishme e mbledhjes së të ardhurave nga kjo taksë, pritshmëria për rritjen ekonomike dhe për kompensimin e punonjësve, politikat e reja, si dhe nga vazhdimësia e efekteve të miradministrimit. Të ardhurat nga taksimi individual në raport me PBB-në janë stabilizuar tashmë në nivelet 2.3 për qind, nga 1-1.5 për qind të viteve 2005-2006.

Te ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera

Parashikimi për periudhën 2012-2014 është: 25.1 miliardë lekë për vitin 2012, 27.1 miliardë lekë për vitin 2013 dhe 29.2 miliardë lekë për vitin 2014, me rritje vjetore përkatësisht 12.5%, 8.1% dhe 7.8%. Zërat me të rëndësishëm në këtë grup janë: renta minerare, taksa e qarkullimit rrugor, taksa mbi transaksionin e makinave të përdorura dhe taksat mbi lojërat e fatit dhe kazinotë, që do të jenë dhe kontribuesit kryesorë në rritje.

Të ardhurat nga taksa doganore

Parashikimi për periudhën 2012-2014 është: 7.0 miliardë lekë për vitin 2012, 7.4 miliardë lekë për vitin 2013 dhe 7.8 miliardë lekë për vitin 2014, me rritje vjetore përkatësisht -10.0%, 5.8% dhe 5.9%. Trendi i ecurisë së këtij zëri është pozitiv, duke qenë se pjesa më e madhe e detyrimeve në kuadër të MTL-ve është plotësuar dhe të ardhurat do të ndikohen nga efekti pozitiv i rritjes së importeve, si rezultat i rritjes ekonomike dhe uljes së barrierave tarifore në tregti.

Të ardhurat nga fondet speciale

Parashikimi për periudhën 2012-2014 është: 61.1 miliardë lekë për vitin 2012, 63.7 miliardë lekë për vitin 2013 dhe 66.5 miliardë lekë për vitin 2014, me rritje vjetore përkatësisht 5.3%, 4.4% dhe 4.4%. Raporti i këtyre të ardhurave ndaj PBB-së do të stabilizohet në nivelin 4.2-4.3 për qind. Parashikimi i të ardhurave nga kontributet për vitin 2010 bazohet në ecurinë e deritanishme të mbledhjes së të ardhurave dhe ecuria e sektorëve të veçantë të ekonomisë.

Lidhja nr.1

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2007	2008	2009	2010	2011 Para.	2012 Para.	2013 Para.	2014 Para.
Popullsia	Milion	3.16	3.17	3.18	3.19	3.21	3.22	3.23	3.23
Norma e inflacionit (mesatar)	%	2.9	3.4	2.3	3.6	3.5	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	3.6	4.7	2.3	2.5	2.7	1.6	1.5	1.5
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	90.4	83.9	95.0	103.9	100.5	102.0	102.5	104.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	123.9	122.8	131.6	137.8	139.1	139.0	139.2	139.2
Rritja reale e PBB	%	5.9	7.5	3.3	3.8	5.0	5.1	5.0	5.2
PBB	Lek miliardë	967.7	1,089.3	1,151.0	1,224.9	1,319.8	1,408.9	1,501.7	1,602.0
PBB	USD miliardë	10.7	13.0	12.1	11.8	13.1	13.8	14.7	15.4
PBB	Euro miliard	7.8	8.9	8.7	8.9	9.5	10.1	10.8	11.5
PBB për banor	Lek mijë	306.0	343.8	361.4	383.4	411.7	437.9	465.1	495.6
PBB për banor	USD	3,384.3	4,098.6	3,804.9	3,689.3	4,096.4	4,293.4	4,537.5	4,765.4
PBB për banor	Euro	2,470.5	2,800.8	2,746.5	2,782.8	2,959.7	3,150.6	3,341.2	3,561.6
PBB për banor	USD-PPP	7,116.9	7,996.3	8,405.2	8,917.0	9,574.2	10,184.4	10,816.2	11,525.6
Norma e papunësisë	%	13.2	12.7	13.8	13.3	12.7	11.6	10.4	9.3
Llogaria korente	% të PBB	-10.6	-15.5	-15.5	-11.9	-11.5	-10.2	-9.1	-7.9
Bilanci i mallrave	% të PBB	-26.9	-27.4	-26.5	-23.5	-21.5	-19.1	-17.7	-16.3
Bilanci i shërbimeve	% të PBB	0.2	0.8	1.4	2.2	3.0	3.0	3.6	3.8
Bilanci i Pagesave	% të PBB	1.9	2.2	-0.4	0.7	1.2	2.4	3.4	3.3

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave



Lidhja nr.2

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR
ne milion Leke

Nr.	E M E R T I M I	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
						Buxheti Rishikuar	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TE ARDHURAVE	251,555	291,238	298,981	324,721	344,047	367,212	391,749	417,651
I.	Ndihmat	1,280	4,228	4,430	4,605	8,422	11,480	14,112	14,687
II.	Te ardhura tatimore	228,164	264,421	270,830	288,564	315,397	340,603	367,700	397,713
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	176,808	205,292	208,870	223,019	242,077	260,658	281,612	304,816
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	87,771	107,094	110,062	113,998	120,056	129,245	139,406	151,154
2	Tatimi mbi Fitimin	21,077	18,108	17,149	17,606	21,127	22,794	24,772	26,843
3	Akczat	28,731	32,510	33,504	38,788	41,270	44,606	48,212	52,211
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	14,850	24,498	26,820	27,058	29,493	31,879	34,645	37,473
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	14,531	14,423	13,405	18,295	22,320	25,106	27,142	29,264
6	Taksa Doganore	9,848	8,660	7,929	7,274	7,812	7,028	7,434	7,872
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	9,366	11,307	12,149	11,898	15,300	18,863	22,346	26,356
1	Taksa lokale	7,134	7,137	8,154	7,684	10,930	13,108	15,861	19,033
2	Tatimi mbi Pasurine(ndertesat)	0	1,586	1,509	1,896	1,850	2,815	3,293	3,853
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	2,232	2,584	2,486	2,318	2,520	2,940	3,192	3,469
II.3	Te ardhura nga fondet speciale	41,989	47,822	49,812	53,647	58,020	61,082	63,742	66,541
1	Sigurimi Shoqeror	37,562	42,547	44,344	45,041	50,010	52,486	54,943	57,405
2	Sigurimi Shendetesor	4,427	5,275	5,467	6,432	6,610	7,096	7,598	8,136
3	Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve					1,400	1,500	1,200	1,000
III.	Te ardhura jotatimore	22,112	22,588	23,720	31,552	20,228	15,129	9,937	5,251
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	5,010	5,700	6,241	4,936	5,200	4,000	3,500	3,100
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	9,458	8,919	9,338	13,994	10,323	8,929	5,137	1,551
3	Dividenti	0	6,402	374	735	500	700	500	300
4	Tarifat sherbimeve	0	0	4,183	2,977	3,000	1,000	600	200
5	Te tjera	7,644	1,567	3,584	8,910	1,205	500	200	100
	TOTALI I SHPENZIMEVE	285,674	351,492	379,863	362,752	390,859	408,776	436,048	464,910
I.	Shpenzime Korrente	224,976	250,298	283,898	300,878	311,538	331,034	354,260	376,133
I.1	Personeli	59,087	66,621	62,359	65,762	68,747	71,701	74,304	77,057
1	Paga	49,663	55,983	53,272	56,951	58,734	60,954	63,222	65,433
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	9,425	10,637	9,087	8,811	9,013	9,447	9,782	10,124
3	Politikat e reja pagash	0	0	0	0	1,000	1,300	1,300	1,500
I.2	Interesat	25,594	31,307	36,301	41,604	46,838	51,300	56,918	59,812
1	Te brendshme	23,499	28,386	31,408	35,583	38,700	41,700	46,600	49,700
2	Te Huaja	2,096	2,921	4,893	6,021	8,138	9,600	10,318	10,112
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	25,259	28,788	32,058	34,318	28,971	29,917	31,255	33,130
I.4	Subvencionet	3,536	2,555	2,004	3,535	1,759	1,600	1,500	1,400
I.5	Shpenzime per Sig. Sociale dhe transferime te tjera	69,892	76,199	96,725	106,207	116,201	122,724	130,757	138,848
1	Sigurime Shoqerore	60,824	65,823	73,744	79,316	85,100	90,140	96,414	102,698
2	Politika te reja pensionesh	0	0	0	0	1,634	1,650	1,700	1,800
3	Sigurime Shendetesore	9,068	10,376	22,980	25,141	27,767	28,934	30,443	31,850
4	Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	0	0	0	1,750	1,700	2,000	2,200	2,500
I.6	Buxheti lokal	21,340	27,079	33,583	30,764	29,314	33,493	37,826	42,886
1	Buxheti lokal (Granti)	11,973	15,772	21,434	18,866	14,014	14,630	15,480	16,530
2	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)	9,366	11,307	12,149	11,898	15,300	18,863	22,346	26,356
I.7	Shpenzime te tjera	15,268	17,750	20,867	18,688	19,708	20,300	21,700	23,000
1	Pagesa e papunesise	869	825	868	982	1,050	1,000	1,100	1,100
2	Ndihma Ekonomike	13,491	15,925	16,060	16,706	16,858	17,300	18,300	19,400
3	Kompensim per te perndjekurit politike	0	1,000	2,200	1,000	1,800	2,000	2,300	2,500
4	Kompensim per energjin elektrike	408	0	0	0	0	0	0	0
II.	Fondi Rezerve	0	0	0	0	5,575	5,500	7,500	11,500
1	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	0	0	0	0	1,928	1,500	1,500	1,500
2	Fond Kontigjence per ruajtjen e deficitit	0	0	0	0	3,647	4,000	6,000	10,000
III.	Shpenzime Kapitale	57,040	93,783	95,881	67,492	73,746	72,242	74,288	77,277
1	Financimi Brendshem	48,220	50,046	75,600	46,642	41,023	31,000	21,962	23,619
2	Financimi Huaj	8,819	43,587	20,281	20,850	32,523	41,242	52,326	53,658
IV	Transferta te ndryshme	3,658	7,411	85	-5,618	0	0	0	0
	DEFICITI	-34,119	-60,254	-80,883	-38,031	-46,812	-41,564	-44,299	-47,259
	FINANCIMI DEFICITIT	34,119	60,254	80,883	38,031	46,812	41,564	44,299	47,259
	Brendshem	28,829	24,417	70,701	27,819	30,062	21,982	18,154	25,345
	Te ardhura nga Privatizimi	13,246	5,538	25,138	411	300	300	300	300
	Hua-marje e brendeshme	17,039	18,012	43,339	25,948	29,463	21,682	17,854	25,045
	Te tjera	-1,456	866	2,224	1,460	300	0	0	0
	I Huaj	5,289	35,837	10,182	10,212	16,750	19,582	26,144	21,914
	Hua afatgjate(e marre)	9,109	39,794	15,375	18,429	26,601	29,762	38,214	38,971
	Ndryshimi i gjendjes se arkës	279	292	567	-1,705	0	0	0	0
	Ripagesat	-4,098	-4,248	-5,760	-6,512	-9,851	-10,180	-12,070	-17,057
MEMO:									
	Borxhi Publik Total (Stok)	516,923	595,786	682,403	715,475	784,186	834,219	880,592	929,386
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	489,521	559,238	636,629	670,049	716,262	757,526	801,525	848,483
	I Brendshem (stok)	369,536	395,504	409,501	401,821	431,284	452,966	470,820	495,865
	I Huaj (stok), nga i cili:	119,985	163,734	227,128	268,228	284,978	304,560	330,704	352,618
	Pushteti Vendor (stok)	0	0	0	147	219	500	1,500	1,500
	Borxhi publik jashte buxhetit (stok)	27,402	36,548	45,774	45,425	67,924	76,693	79,067	80,902
	Borxhi publik i garantuar (stok)	27,402	36,548	45,774	45,425	47,184	52,933	50,095	46,528
	Borxh nga disbursimet jashte buxhetit (stok)					10,800	8,800	8,800	8,800
	Provizijon per riskun nga kursi i kembimit (flow)					9,940	5,020	5,212	5,403
	PBB nominal	967,670	1,089,293	1,151,020	1,224,881	1,319,836	1,408,939	1,501,670	1,601,982

Burimi: Ministria e Financave

Lidhja nr.2/1

TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR
ne % te Produktit te Brendshem Bruto

Nr.	E M E R T I M I	2007	2008	2009	2010	2011 Buxheti Rishikuar	2012 PBA	2013 PBA	2014 PBA
	TOTALI TE ARDHURAVE	26.0	26.7	26.0	26.5	26.1	26.1	26.1	26.1
I.	Ndihmat	0.1	0.4	0.4	0.4	0.6	0.8	0.9	0.9
II.	Te ardhura tatimore	23.6	24.3	23.5	23.6	23.9	24.2	24.5	24.8
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	18.3	18.8	18.1	18.2	18.3	18.5	18.8	19.0
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	9.1	9.8	9.6	9.3	9.1	9.2	9.3	9.4
2	Tatimi mbi Fitimin	2.2	1.7	1.5	1.4	1.6	1.6	1.6	1.7
3	Akcizat	3.0	3.0	2.9	3.2	3.1	3.2	3.2	3.3
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	1.5	2.2	2.3	2.2	2.2	2.3	2.3	2.3
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	1.5	1.3	1.2	1.5	1.7	1.8	1.8	1.8
6	Taksa Doganore	1.0	0.8	0.7	0.6	0.6	0.5	0.5	0.5
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	1.0	1.0	1.1	1.0	1.2	1.3	1.5	1.6
1	Taksa lokale	0.7	0.7	0.7	0.6	0.8	0.9	1.1	1.2
2	Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	0.0	0.1	0.1	0.2	0.1	0.2	0.2	0.2
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
II.3	Te ardhura nga fondet speciale	4.3	4.4	4.3	4.4	4.4	4.3	4.2	4.2
1	Sigurimi Shoqeror	3.9	3.9	3.9	3.7	3.8	3.7	3.7	3.6
2	Sigurimi Shendetesor	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5
3	Te ardhurat per kompensimin ne vlere te pronareve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
III.	Te ardhura jotatimore	2.3	2.1	2.1	2.6	1.5	1.1	0.7	0.3
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0.5	0.5	0.5	0.4	0.4	0.3	0.2	0.2
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	1.0	0.8	0.8	1.1	0.8	0.6	0.3	0.1
3	Dividenti	0.0	0.6	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
4	Tarifat sherbimeve	0.0	0.0	0.4	0.2	0.2	0.1	0.0	0.0
5	Te tjera	0.8	0.1	0.3	0.7	0.1	0.0	0.0	0.0
	TOTALI I SHPENZIMEVE	29.5	32.3	33.0	29.6	29.6	29.0	29.0	29.0
I.	Shpenzime Korrente	23.2	23.0	24.7	24.6	23.6	23.5	23.6	23.5
I.1	Personeli	6.1	6.1	5.4	5.4	5.2	5.1	4.9	4.8
1	Paga	5.1	5.1	4.6	4.6	4.5	4.3	4.2	4.1
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	1.0	1.0	0.8	0.7	0.7	0.7	0.7	0.6
3	Politikat e reja pagash	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
I.2	Interesat	2.6	2.9	3.2	3.4	3.5	3.6	3.8	3.7
1	Te brendshme	2.4	2.6	2.7	2.9	2.9	3.0	3.1	3.1
2	Te Huaja	0.2	0.3	0.4	0.5	0.6	0.7	0.7	0.6
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	2.6	2.6	2.8	2.8	2.2	2.1	2.1	2.1
I.4	Subvencionet	0.4	0.2	0.2	0.3	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime per Sig.Sociale dhe transferime te tjera	7.2	7.0	8.4	8.7	8.8	8.7	8.7	8.7
1	Sigurime Shoqerore	6.3	6.0	6.4	6.5	6.4	6.4	6.4	6.4
2	Politika te reja pensionesh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
3	Sigurime Shendetesore	0.9	1.0	2.0	2.1	2.1	2.1	2.0	2.0
4	Shpenzime per Kompensimin ne Vlere te Pronareve	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2
I.6	Buxheti lokal	2.2	2.5	2.9	2.5	2.2	2.4	2.5	2.7
1	Buxheti lokal (Granti)	1.2	1.4	1.9	1.5	1.1	1.0	1.0	1.0
2	Buxheti lokal (Te ardhurat e veta)	1.0	1.0	1.1	1.0	1.2	1.3	1.5	1.6
I.7	Shpenzime te tjera	1.6	1.6	1.8	1.5	1.5	1.4	1.4	1.4
1	Pagesa e papunesise	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Ndihma Ekonomike	1.4	1.5	1.4	1.4	1.3	1.2	1.2	1.2
3	Kompensim per te perndjekurit politike	0.0	0.1	0.2	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2
4	Kompensim per energjin elektrike	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
II.	Fondi Rezerve	0.0	0.0	0.0	0.0	0.4	0.4	0.5	0.7
1	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Fond Kontigjence per ruajtjen e deficitit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.3	0.3	0.4	0.6
III.	Shpenzime Kapitale	5.9	8.6	8.3	5.5	5.6	5.1	4.9	4.8
1	Financimi Brendshem	5.0	4.6	6.6	3.8	3.1	2.2	1.5	1.5
2	Financimi Huaj	0.9	4.0	1.8	1.7	2.5	2.9	3.5	3.3
IV.	Transferta te ndryshme	0.4	0.7	0.0	-0.5	0.0	0.0	0.0	0.0
	DEFICITI	-3.5	-5.5	-7.0	-3.1	-3.5	-3.0	-3.0	-3.0
	FINANCIMI DEFICITIT	3.5	5.5	7.0	3.1	3.5	3.0	2.9	3.0
	Brendshem	3.0	2.2	6.1	2.3	2.3	1.6	1.2	1.6
	Te ardhura nga Privatizimi	1.4	0.5	2.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Hua-marje e brendeshme	1.8	1.7	3.8	2.1	2.2	1.5	1.2	1.6
	Te tjera	-0.2	0.1	0.2	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
	I Huaj	0.5	3.3	0.9	0.8	1.3	1.4	1.7	1.4
	Hua afatgjate(e marre)	0.9	3.7	1.3	1.5	2.0	2.1	2.5	2.4
	Ndryshimi i gjendjes se arkës	0.0	0.0	0.0	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ripagesat	-0.4	-0.4	-0.5	-0.5	-0.7	-0.7	-0.8	-1.1
	MEMO:								
	Borxhi Publik Total (Stok)	53.4	54.7	59.3	58.4	59.4	59.2	58.6	58.0
	Borxhi publik nga buxheti (stock)	50.6	51.3	55.3	54.7	54.3	53.8	53.4	53.0
	I Brendshem (stock)	38.2	36.3	35.6	32.8	32.7	32.1	31.4	31.0
	I Huaj (stock), nga i cili:	12.4	15.0	19.7	21.9	21.6	21.6	22.0	22.0
	Pushteti Vendor (stock)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1
	Borxhi publik jashte buxhetit (stok)	2.8	3.4	4.0	3.7	5.1	5.4	5.3	5.1
	Borxhi publik i garantuar (stok)	2.8	3.4	4.0	3.7	3.6	3.8	3.3	2.9
	Borxh nga disbursimet jashte buxhetit (stok)					0.8	0.6	0.6	0.5
	Provigion per riskun nga kursi i kembimit (flow)					0.8	0.4	0.3	0.3
	PBB nominal	967,670	1,089,293	1,151,020	1,224,881	1,319,836	1,408,939	1,501,670	1,601,982

Burimi: Ministria e Financave



C. Programet buxhetore afatmesme të ministrive të linjës

Kërkesat për shpenzime buxhetore të PBA 2012-2014 për të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale të tyre janë paraqitur duke mbajtur në konsideratë tavanet e miratuara nga KPS dhe të dërguara nëpërmjet udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8/2, datë 6.7.2011 “Për përgatitjen e Buxhetit të Shtetit dhe fondet speciale”, si edhe në përputhje me shpërndarjen e tyre sipas strukturës programore të çdo institucioni (aneksi 1)

C.1 MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Misioni i ministrisë:


Të plotësohet misioni i ministrisë. Ministria e Shëndetësisë ka si mision realizimin e politikës shëndetësore të programit të qeverisë. Ministria e shëndetësisë harton politikën shëndetësore në shkallë vendi, përcakton zhvillimin planifikimin e shërbimit shëndetësor në nivel kombëtar dhe sipas zonave. Harton legjislacionin që përcakton marrëdhëniet në fushën e ruajtjes dhe mbrojtjes së shëndetit dhe zbaton me rigorozitet legjislacionin në fushën e shëndetësisë. Harton strategjinë e zhvillimit shëndetësor dhe taktikave të vënies në jetë të programit të qeverisë. Studion dhe harton programin e investimeve në zhvillimin e infrastrukturës së shërbimit shëndetësor. Kryen drejtimin operativ të shërbimit shëndetësor në shkallë kombëtare dhe sipas zonave. Për realizimin e funksioneve të saj, ajo funksionon sipas organikës dhe strukturës organizative të miratuar. Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar në drejtori e sektorë sipas strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Ky mision do të realizohet nëpërmjet programeve të mëposhtme:


Programet

Titulli	Emri	Përshkrimi
0110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	Ky program mbulon funksione që kryen aparati i ministrisë së shëndetësisë, Qendra Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim
0520	Shërbime të Kujdesit Parësor	Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet përmes një rrjeti ekstensiv të përbërë nga qendra shëndetësore urbane dhe rurale, si edhe nga ambulanca fshatrash. Ky program ofron shërbimet e kujdesit mjekësor bazë, si edhe një paketë programesh parandaluese, veçanërisht ato të imunizimit dhe të shëndetit riprodhues, nëpërmjet 603 Qsh dhe 1500 ambulanca të fshatrave. Shërbimet e specializuara ofrohen për pacientët e referuar nga mjeku i familjes drejt shërbimit ambulator të specializuar ose poliklinikave të specialiteteve pranë spitaleve.
0530	Shërbimet e kujdesit dytësor	Ky program mbulon shërbimet e ofruara nga strukturat e kujdesit të specializuar me shtretër (inpatient) ose jo (outpatient). Ky program ofrohet nga 42 spitale (institucione buxhetore me struktura të veçanta), si dhe një rrjet poliklinikash të specializuara.
0550	Shëndeti publik	Shërbimi i SHP ofrohet nëpërmjet programeve kombëtare të imunizimit, TBC, HIV/AIDS dhe IST, tëurvejancës epidemiologjike dhe ndjekjes së sëmundshmërisë infektive (sëmundshmërisë me origjinë nga uji, ushqimet etj), sëmundshmërisë kronike me pasojë në shëndet publik të ndikuara nga kushtet e mjedisit (shëndeti mjedisor, të shërbimeve higjeno-sanitare dhe epidemiologjike me laboratorët e tyre (LSHP në nivel nacional e lokal), si dhe të programeve të sigurisë ushqimore, kontrollit të ujit të pijshëm, shëndetit riprodhues.


Shpenzimet buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë, në nivel programi për periudhën e PBA-së, jepen në grafikun e mëposhtëm:



Shpenzimet buxhetore të po këtij institucioni, në nivel ministrie, për periudhën e PBA, jepen në grafikun e mëposhtëm.



Ndërsa, shpenzimet e Ministrisë së Shëndetësisë, në përqindje ndaj PBB-së paraqiten në grafikun në vijim:





01110 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi

1. Politika e programit

Përshkrimi i programit

Ky program mbulon funksione që kryen aparati i Ministrisë së Shëndetësisë, Qendra Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim.

Përshkrimi i politikës së programit

Ky program mbulon funksione të formulimit të politikave e strategjive për të gjitha shërbimet shëndetësore, hartimin e përmirësimit e kuadrit ligjor dhe standardeve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, ngritjen e përmirësimit e kapaciteteve planifikuese e menaxhuese, hartimin e planit të investimeve në zhvillimin e infrastrukturës së kujdesit shëndetësor, licencimin, akreditimin, monitorimin, inspektimin etj.

Qëllimi i politikës së programit

Përbushja 100% e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e shëndetësisë deri në vitin 2015; plotësimi 100% i një kuadri ligjor në përputhje me direktivat europiane deri në vitin 2015; përmirësimi i kapaciteteve menaxheriale në masën 50% deri në vitin 2015; ngritja e sistemit dhe akreditimi i institucioneve shëndetësore deri në 2020; sistem informacioni i plotë dhe i integruar në të gjithë vendin deri në vitin 2015; përbushja e detyrimeve të MSH në përputhje me misionin e saj.

Objektivat e politikës së programit

Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
1) Arritja e 100% e angazhimeve kombëtare dhe 30% e angazhimeve ndërkombëtare. 2) Plotësimi 100% i angazhimeve ligjore në fushën e shëndetësisë. 3) Zbatimi i planit afatshkurtër të përafrimit të legjislacionit. 4) Drejtimi i aparatit të MSH në përputhje me misionin e saj. 5) Akreditimi i 10 spitaleve të tjera.	1) Arritja e 100% e angazhimeve kombëtare dhe 60% e angazhimeve ndërkombëtare. 2) Plotësimi 100% i angazhimeve ligjore në fushën e shëndetësisë. 3) Ngritja e kapaciteteve menaxheriale në fushën e shëndetësisë në masën 20 %. 4) Akreditimi i 10 spitaleve të tjera.	1) Arritja e 100% e angazhimeve kombëtare dhe 60% e angazhimeve ndërkombëtare. 2) Plotësimi 100% i angazhimeve ligjore në fushën e shëndetësisë. 3) Ngritja e kapaciteteve menaxheriale në fushën e shëndetësisë në masën 20 %. 4) Akreditimi i 10 spitaleve të tjera. 5) Drejtimi i aparatit të MSH në përputhje me misionin e saj.	1) Arritja e 100% e angazhimeve kombëtare dhe 60% e angazhimeve ndërkombëtare. 2) Plotësimi 100% i angazhimeve ligjore në fushën e shëndetësisë. 3) Ngritja e kapaciteteve menaxheriale në fushën e shëndetësisë në masën 20% 4) Akreditimi i 10 spitaleve të tjera. 5) Drejtimi i aparatit të MSH në përputhje me misionin e saj.

Standardet e politikës së programit

Dokumentet strategjike të hartuar në përputhje me udhëzimet e DBSKNH; legjislacioni i hartuar në përputhje me direktivat europiane; personat e trajnuar sipas sistemit të krediteve të QKEV; udhëzuesit dhe protokollet klinike të përgatitura në përputhje me rekomandimet e OBSH; punonjësit e MSH të pranuar sipas Statusit të Nënunësit Civil.

2. Produktet e programit 2012-2014

Projekti	03090	Rikonstruksion dhe ndërtim ambientesh
----------	-------	---------------------------------------

Produkti	A	Sipërfaqe të rikonstruktura			
Përshkrimi	Këtu përfshihen ndërtime dhe rikonstruksione për institucionet e këtij programi.				
Objektivat	0) Arritja e 100% e angazhimeve kombëtare dhe 30% e angazhimeve ndërkombëtare. 1) Arritja e 100% e angazhimeve kombëtare dhe 60% e angazhimeve ndërkombëtare. 2) Arritja e 100% e angazhimeve kombëtare dhe 60% e angazhimeve ndërkombëtare. 3) Arritja e 100% e angazhimeve kombëtare dhe 60% e angazhimeve ndërkombëtare.				
Njësia		Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2012-2014		
Sasia	m ²	2011	2012	2013	2014
		500	0	0	0
Totali i shpenzimeve		30.280,0	0,0	0,0	0,0
Shpenzime për njësi		60.56	0,0	0,0	0,0

Projekti	03091	Blerje pajisjesh mobilimi, zyre dhe kompjuterike
----------	-------	--

Produkti	B	Pajisje mobilimi dhe zyre të reja të blera			
Përshkrimi	Blerja e pajisjeve te mobilimit dhe zyrës për Ministrinë e Shëndetësisë				
Objektivat					
Njësia		Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2012-2014		
		2011	2012	2013	2014
Sasia	Numri i pajisjeve	10	10	10	10
Totali i shpenzimeve		Mijëra lekë	6.720,0	5.000,0	5.000,0
Shpenzime për njësi		Mijëra lekë	672,0	500,0	500,0

Projekti	03092	Projekte të mbështetura me kosto lokale
----------	-------	---

Produkti	C	Projekte ndërtimi dhe rikonstruksioni				
Përshkrimi	Këtu përfshihen kryerja e projekteve për ndërtimet dhe rikonstruksioneve të institucioneve të këtij programi					
Objektivat	0) Zbatimi i planit afatshkurtër të përafrimit të legjislacionit. 1) Ngritja e kapaciteteve menaxheriale në fushën e shëndetësisë në masën 20 %. 2) Ngritja e kapaciteteve menaxheriale në fushën e shëndetësisë në masën 20 %. 3) Ngritja e kapaciteteve menaxheriale në fushën e shëndetësisë në masën 20 %.					
Njësia		Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2012-2014			
Sasia	Numri i projekteve	2011	2012	2013	2014	
		1	3	3	3	
Totali i shpenzimeve		Mijëra lekë	3.000,0	5.000,0	5.000,0	5.000,0
Shpenzime për njësi		Mijëra lekë	3.000,0	1.666,67	1.666,67	1.666,67

Projekti	03068	Shpenzime jashtë projekteve
----------	-------	-----------------------------

Produkti	D	Menaxhimi i politikës sektoriale
Përshkrimi	Hartimi i dokumenteve politike dhe strategjike dhe funksionimi i aparatit të Ministrisë së Shëndetësisë	



Objektivat	0) Plotësimi 100% i angazhimeve ligjore në fushën e shëndetësisë. 1) Plotësimi 100% i angazhimeve ligjore në fushën e shëndetësisë. 2) Plotësimi 100% i angazhimeve ligjore në fushën e shëndetësisë. 3) Plotësimi 100% i angazhimeve ligjore në fushën e shëndetësisë.				
Njësia	Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2012-2014			
Sasia	2011	2012	2013	2014	
Numri i dokumenteve të prodhuar	18	21	22	25	
Totali i shpenzimeve	Mijëra lekë	234.017,0	246.500,0	269.000,0	293.000,0
Shpenzime për njësi	Mijëra lekë	13.000,94	11.738,1	12.227,27	11.720,0

0520 Shërbime të kujdesit parësor

1. Politika e programit

Përshkrimi i programit

Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet përmes një rrjeti ekstensiv të përbërë nga qendra shëndetësore urbane dhe rurale, si edhe nga ambulanca fshatrash. Ky program ofron shërbimet e kujdesit mjekësor bazë, si edhe një paketë programesh parandaluese, veçanërisht ato të imunizimit dhe të shëndetit riprodhues, nëpërmjet 603 QSH dhe 1500 ambulanca të fshatrave. Shërbimet e specializuara ofrohen për pacientët e referuar nga mjeku i familjes drejt shërbimit ambulator të specializuar ose poliklinikave të specialiteteve pranë spitaleve.

Përshkrimi i politikës së programit

Ofrimi i shërbimeve cilësore të kujdesit shëndetësor parësor të bazuar në parimet e mjekësisë familjare nëpërmjet zbatimit të shërbimeve që përfshihen në paketën bazë të kujdesit shëndetësor parësor, standardeve dhe normave të miratuara. Forcimi i autonomisë së QSH.

Qëllimi i politikës së programit

Përmirësim i ofrimit të shërbimit shëndetësor parësor nëpërmjet zgjerimit të skemës së rimbursimit të medikamenteve nga 409 që rimburohen aktualisht në 510 në vitin 2015. Akreditim i të gjitha institucioneve të kujdesit parësor, sipas standardeve të akreditimit të cilësisë, në vitin 2017. Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore në 10/1000 në vitin 2015 krahasuar me 12/1000 në 2009. Përgjysmim i vdekshmërisë amtare në vitin 2015 krahasuar me vitin 2001 (22.7 vdekje/100000 lindje). Rritja e vizitave/kontakteve të pacientit në kujdesin parësor në 15 vizita/ditë/mjek në vitin 2016 nga 7 që është aktualisht. Plotësim në masën 100% të standardeve minimale të infrastrukturës në vitin 2020, referuar 40% që plotësohen aktualisht.

Objektivat e politikës së programit

Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
1) Përmirësim i ofrimit të shërbimit parësor nëpërmjet zgjerimit të skemës së medikamenteve nga 409 që ishin në 2010-n, në 420 barna në vitin 2011. 2) Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore në vitin 2011 me 0.5 për 1000 krahasuar me vitin 2010. 3) Zvogëlim i vdekshmërisë amtare me 1/100000 në vitin 2011 krahasuar me 17 për 100000 që është në vitin 2008. 4) Rritja e vizitave/kontakteve të pacientit në kujdesin parësor në 8.6 vizita/ditë/mjek në vitin 2011 nga 8.4 në vitin 2010. 5) Plotësim në masën 50% të standardeve të infrastrukturës	1) Përmirësim i ofrimit të shërbimit parësor nëpërmjet zgjerimit të skemës së medikamenteve nga 420 në vitin 2011, në 430 në vitin 2012. 2) Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore në vitin 2012 me 0.5 për 1000 krahasuar me vitin 2011. 3) Zvogëlim i vdekshmërisë amtare me 1/100000 në vitin 2012 krahasuar me 16 për 100000 në vitin 2010. 4) Rritja e vizitave/kontakteve të pacientit në kujdesin parësor në 8.8 vizita/ditë/mjek në vitin 2012 nga 8.6 në vitin 2011. 5) Plotësim në masën 58% të standardeve të infrastrukturës	1) Përmirësim i ofrimit të shërbimit parësor nëpërmjet zgjerimit të skemës së medikamenteve nga 430 në vitin 2012 në 450 në vitin 2013. 2) Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore në vitin 2013 me 0.5 për 1000 krahasuar me vitin 2012. 3) Zvogëlim i vdekshmërisë amtare me 1/100000 në vitin 2013 krahasuar me 19 për 100000 në vitin 2012. 4) Rritja e vizitave/kontakteve të pacientit në kujdesin parësor në 9 vizita/ditë/mjek në vitin 2013 nga 8.8 në vitin 2012. 5) Plotësim në masën 60% të standardeve të infrastrukturës	1) Përmirësim i ofrimit të shërbimit parësor nëpërmjet zgjerimit të skemës së medikamenteve nga 450 në vitin 2012 në 460 në vitin 2013. 2) Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore në vitin 2014 me 0.5 për 1000 krahasuar me vitin 2013. 3) Zvogëlim i vdekshmërisë amtare me 1/100000 në vitin 2014 krahasuar me 19 për 100000 në vitin 2012. 4) Rritja e vizitave/kontakteve të pacientit në kujdesin parësor në 9.2 vizita/ditë/mjek në vitin 2014 nga 9 në vitin 2013. 5) Plotësim në masën 62% të standardeve të infrastrukturës krahasuar me

krahasuar me 40% që realizohen në 2010-n. 6) Ulja e nivelit të kariesit dentar në grupmoshën 12-13 vjeç nga 82% në vitin 2010, në 80%. 7) 8% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit.	krahasuar me 50% që realizohen në 2011-n. 6) Ulja e nivelit të kariesit dentar në grupmoshën 12-13 vjeç nga 80% në vitin 2010, në 78%. 7) 9% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit.	krahasuar me 58% që realizohen në 2012. 6) Ulja e nivelit të kariesit dentar në grupmoshën 12-13 vjeç nga 78% që ishte në vitin 2012, në 77% në vitin 2013. 7) 9% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit. 8) Zhvillim profesional i 200 mjekëve të përgjithshëm në mjek familje në vitin 2013.	60% që realizohen në 2013-n. 6) Ulja e nivelit të kariesit dentar në grupmoshën 12-13 vjeç nga 77% që ishte në vitin 2013, në 78% në vitin 2014. 7) 9% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit. 8) Zhvillim profesional i 200 mjekëve të përgjithshëm në mjek familje në vitin 2014.
Standardet e politikës së programit			
1 mjek për 1700 banorë në fshat. 1 mjek për 2000 banorë në qytet. Ambulanca me infermierë për çdo fshat ku nuk ka mjek. 1 mjek stomatolog për 2500 popullatë të grupmoshës 0-18 vjeç. Projekte tip për ndërtimin e qendrave shëndetësore (T1,T2) dhe ambulancave (A1,A2) miratuar nga Ministri i Shëndetësisë. Set standard i mobilimit të qendrave shëndetësore dhe ambulancave miratuar nga Ministri i Shëndetësisë. Paketa bazë e shërbimeve në KSHP miratuar me urdhër ministri nr.95, datë 16.2.2009. Standardet e cilësisë për akreditimin e institucioneve të KSHP miratuar me urdhër ministri nr.298, datë 14.5.2009. Standardet e pajisjeve dhe funksionimit të laboratorëve klinikë në KSHP miratuar me urdhër ministri..... Dokumenti strategjik për shëndetin riprodhues dhe plani i veprimit për vitet 2010-2015 miratuar me urdhër ministri nr.620, datë 17.11.2009. Standardet e cilësisë për akreditimin e institucioneve të shërbimit stomatologjik miratuar me urdhër ministri nr.....			

2. Produktet e programit 2012-2014

Projekti	03069	Shpenzime jashtë projekteve
----------	-------	-----------------------------

Produkti	A	Pacientë të trajtuar në klinikën qeveritare			
Përshkrimi	Këtu përfshihen shpenzimet qe kryhen për pacientët të cilët janë anëtarë të qeverisë apo familjarët e tyre				
Objektivat	0) Zvogëlim i vdekshmërisë amtare me 1/100000 në vitin 2011 krahasuar me 17 për 100000 që është në vitin 2008. 1) Zvogëlim i vdekshmërisë amtare me 1/100000 në vitin 2012 krahasuar me 16 për 100000 në vitin 2010. 2) Zvogëlim i vdekshmërisë amtare me 1/100000 në vitin 2013 krahasuar me 19 për 100000 në vitin 2012. 3) Zvogëlim i vdekshmërisë amtare me 1/100000 në vitin 2014 krahasuar me 19 për 100000 në vitin 2012.				
Njësia		Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2012-2014		
		2011	2012	2013	2014
Sasia	Numri i pacientëve të trajtuar	580	660	700	750
Totali i shpenzimeve		Mijëra lekë	28.000,0	33.100,0	35.800,0
Shpenzime për njësi		Mijëra lekë	48,28	50,15	51,14

Projekti	03069	Shpenzime jashtë projekteve
----------	-------	-----------------------------

Produkti	B	Vizita të kryera në Klinikën Stomatologjike Universitare			
Përshkrimi	Këtu përfshihet trajtimi për probleme stomatologjike i disa kategorive të pacientëve (invalidë...), kategori të cilat janë përcaktuar në ligj.				
Objektivat	0) 8% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit. 1) 9% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit. 2) 9% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit. 3) 9% e popullsisë e mbuluar me shërbim parandalues çdo vit.				
Njësia		Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2012-2014		
		2011	2012	2013	2014
Sasia	Nr. i vizitave të kryera në KSU	5300	6000	6600	7000
Totali i shpenzimeve		Mijëra lekë	36.265,0	41.100,0	45.000,0
Shpenzime për njësi		Mijëra lekë	6.84	6.85	6.82
					7.16

Projekti	03069	Shpenzime jashtë projekteve
----------	-------	-----------------------------

Produkti	C	Vizita të kryera në kujdesin shëndetësor parësor
Përshkrimi	Këtu përfshihen vizitat për pacientët në kujdesin shëndetësor parësor	



Objektivat	0) Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore në vitin 2011 me 0.5 për 1000 krahasuar me vitin 2010. 1) Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore në vitin 2012 me 0.5 për 1000 krahasuar me vitin 2011. 2) Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore në vitin 2013 me 0.5 për 1000 krahasuar me vitin 2012. 3) Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore në vitin 2014 me 0.5 për 1000 krahasuar me vitin 2013.				
Njësia	Viti aktual	Shpenzimet e planifikuara 2012-2014			
	2011	2012	2013	2014	
Sasia	Numri i vizitave të kryera në KSHP	5900000	5900000	6000000	6100000
Totali i shpenzimeve	Mijëra lekë	1.140.000,0	675.000,0	425.000,0	74.000,0
Shpenzime për njësi	Mijëra lekë	0,19	0,11	0,07	0,01

Projekti	03069	Shpenzime jashtë projekteve
----------	-------	-----------------------------

Produkti	D	Barna të rimbursueshme			
Përshkrimi	Këtu përfshihet lista e medikamenteve (barnave) që i ofrohet popullatës pa pagesë ose me bashkëpagesë				
